



Агенција за млади и спорт



# **STRATEGJIA NACIONALE PËR TË RINJ 2016-2025**



Ky dokument është përgatitur me mbështetjen financiare të Programit për zhvillim të Kombeve të bashkuara (UNDP). Qëndrimet e shpalosura në këtë dokument janë qëndrime të autorëve dhe nuk i shprehin qëndrimet e Kombeve të bashkuara, përfshirë UNDP-në, ose të shteteve anëtare të KB.



## PARATHËNIE

**D**uke marrë parasysh gjendjet shoqërore në të kaluarën, por edhe skadimin e Strategjisë nacionale për të rinj 2005 2015, Agjencia për të Rinj dhe Sport në fillim të vitit 2015 e nxiti procesin krijimit të Strategjisë nacionale të re për të rinj, e cila i shpreh sfidat, qëndrimet dhe nevojat e të rinjve për periudhën e viteve 2016-2025.

Procesi i krijimit të Strategjisë nacionale për të rinj nisi në shkurt të vitit 2015 dhe u zhvillua në tri faza:

- ▲ Thirrje publike për pjesëmarrje në grupet punuese
- ▲ Takime të grupeve punuese në kuadër të fushave parësore të strategjisë
- ▲ Diskutime publike për prezantimin e projekt-tekstit të strategjisë

Si bazë për nxitjen e këtij procesi është hulumtimi i trendëve të rinjtë i bërë nga ana e Institutit të Hulumtimeve Sociologjike dhe Politike në periudhën shtator-dhjetor të vitit 2014.

Kjo Strategji nacionale për të rinjtë, si dokument strategjik është krijuar me pjesëmarrje aktive të të rinjve dhe të institucioneve relevante të cilët në një proces të hapët dhe gjithëpërfshirës i paraqitën qëndrimet dhe nevojat e tyre në kuadër të nëntë fushave parësore të strategjisë.

Përmbajtja e Strategjisë nacionale për të rinj i përfshin prioritetet strategjike, sfidat kryesore me të cilat ballafaqohen të rinjtë dhe objektivat afatgjatë të prezantuara nëpërmjet fushave tematike. Si plotësim i strategjisë, është hartuar një Plan i përgjithshëm me propozim rezultate dhe masa për dhjetë vitet e ardhshme. Pas miratimit të këtij dokumenti strategjik do të vazhdoj procesi i konsultimit për hartimin e planeve dyvjeçare të veprimit,

në të cilat në solucionet tanimë të propozuara në mënyrë të hollësishme do të përcaktohen hapat e ardhshëm, korniza kohore, përgjegjësitë dhe mjetet e nevojshme financiare për realizimin e qëllimeve të parapara. Në bazë të këtij plan operimi të definuar do të hartohet më tutje plani për ndjekjen e realizimit të tij me ç'rast do të mundësohet efikasiteti dhe koordinimi më i madh i përpjekjeve të institucioneve të ndryshme përgjegjëse për realizimin e masave të parapara në këtë strategji.

Një falënderim të veçantë i drejtojmë Programit të Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara që e përkrahu këtë proces që nga fillimi dhe i cili me përkrahjen e tij i dha një vlerë të posaçme këtij procesi.

Falënderim të madh iu drejtojmë të rinjve të cilët besonin në këtë proces dhe të cilët me përkushtimin dhe bashkëpunimin e ndërsjellë e vunë bazën e Strategjisë së dytë nacionale për të rinj. Krijimi i Strategjisë nacionale për të rinj është një prej proceseve më gjithëpërfshirëse dhe transparente në Republikën e Maqedonisë, ku u përfshinë të rinjtë dhe përfaqësuesit e institucioneve relevante dhe të gjitha palët e interesuara në periudhë prej 10 muaj diskutimesh për problemet dhe sfidat e të rinjve. Të rinjtë patën mundësi të flasin rreth asaj se si duhet të duket e ardhmja e tyre, duke shprehur gjithashtu interes dhe angazhim për të kontribuar për ndryshime pozitive në shoqëri.

Në këtë drejtim kjo strategji u takon të gjithë të rinjve në Republikën e Maqedonisë.



**Marjan Spasevski,**  
Drejtor i Agjencisë për të Rinj dhe Sport

Shkup,  
janar 2016





## PËRMBAJTJE

<b>Lista e shkurtesave të përdorura</b>	6
<b>Hyrje</b>	7
<b>Qasja gjatë hartimit të strategjisë</b>	8
<b>Të rinjtë e Republikës së Maqedonisë sot</b>	9
<b>Vizioni 2025</b>	10
<b>Prioritetet strategjike</b>	11
<b>Përcaktimet e valorizimit të strategjisë</b>	11
<b>Fushat tematike</b>	13
<b>Fusha tematike: Pjesëmarrje rinore</b>	13
<b>Fusha tematike: Informimi rinor</b>	15
<b>Fusha tematike: Puna rinore lokale</b>	17
<b>Fusha tematike: Arsimi</b>	19
<b>Fusha tematike: Punësimi dhe përkrahja para punësimit</b>	25
<b>Fusha tematike: Kultura</b>	28
<b>Fusha tematike: Sporti</b>	30
<b>Fusha tematike: Shëndeti</b>	32
<b>Fusha tematike: Cilësia e jetës</b>	35
<b>Aktorët kryesorë dhe rolet dhe përgjegjësitë e tyre</b>	37
<b>Plani i monitorimit</b>	39
<b>Lista e literaturës së shfrytëzuar dhe dokumentet relevante gjatë përpilimit të strategjisë</b>	40



## LISTA E SHKURTESAVE TË PËRDORURA

ARS	Agjencia e të Rinjve dhe Sportit
OC	Organizatrat civile
BE	Bashkimi Evropian
TI	Teknologjitë informative
PLR	Puna lokale e të rinjve
NVM	Ndërmarrje të vogla dhe të mesme
OJQ	Organizata jo qeveritare
NEET	Nuk janë përfshirë në arsim, punë ose stërvitje
SNR	Strategjia nacionale për të rinj
AJF	Arsimi jo formal
SPA	Substancat psikike-aktive
RM	Republika e Maqedonisë
SHSR	Shëndeti seksual reproduktiv



## HYRJE

Të rinjtë janë bartës të ndryshimeve pozitive, si në Republikën e Maqedonisë, ashtu edhe në mbarë botën. Ato janë burim i risive dhe forcë e ardhshme shtytëse e zhvillimit social dhe ekonomik. Të rinjtë i sfidojnë normat dhe vlerat e instaluar dhe i ndërtojnë themelet për të ardhmen e vendit tonë. Republika e Maqedonisë i jep meritën e duhur këtij roli të rëndësishëm të të rinjve. Prandaj është me rëndësi të jashtëzakonshme që rregullisht dhe në mënyrë sistematike të investohet në zhvillimin e tyre, por edhe në aplikimin e mekanizmave për pjesëmarrjen e tyre aktive në proceset shoqërore. Vetëm me ndërtimin e partneritetit të vërtetë ndërmjet institucioneve dhe të rinjve do të sigurojmë që politikat të jenë gjithëpërfshirëse, t'i shprehin dhe adresojnë nevojat reale dhe nxisin integrimin social.

Strategjia nacionale për të rinjtë e Republikës së Maqedonisë 2016-2025 i vendos parimet dhe orientimet themelore për veprim të të gjithë faktorëve në shoqëri të cilat do të çojnë në përmirësimin e pozitës së pavarur ekonomike të të rinjve dhe në krijimin e ambientit i cili do tu mundësojë të rinjve ti realizojnë të drejtat, nevojat dhe interesat e tyre.

Për nevojat e kësaj strategjie, dhe në pajtim me praktikën e deritashme historike, sociale, politike dhe etike, **termi të rinj ka të bëjë me të gjithë personat të moshës prej 15 deri në 29 vjet. Kjo është një kategori e cila në vete bart një potencial kolosal, si burim kryesor për përparimin shoqëror, por edhe me ndjeshmëri të veçantë ndaj ndryshimeve socio-ekonomike në shoqëri.**

Kjo strategji bazohet në përcaktimin për të punuar për dhe me të rinjtë dhe të mundësohen kushte në të cilat të rinjtë do të mund të arrijnë të gjithë potencialin e vet si qytetarë aktivë, të cilët kontribuojnë jo vetëm për zhvillimin e vet personal dhe profesional, por edhe për zhvillimin e tërë shoqërisë.

Me qëllim të qasjes strukturale ndaj një varg çështjesh të lidhura me të drejtat e të rinjve, interesimet e propozuara në këtë strategji janë ndarë në nëntë fusha kryesore dhe atë:

- ▲ Pjesëmarrje e të rinjve
- ▲ Informimi i të rinjve
- ▲ Puna lokale e të rinjve
- ▲ Arsimi
- ▲ Punësimi dhe përkrahje para punësimit
- ▲ Kultura
- ▲ Sporti
- ▲ Shëndeti
- ▲ Cilësia e jetës

Strategjia nacionale e të rinjve në Republikën e Maqedonisë 2016-2025 bazohet në dokumentet ndërkombëtare të ratifikuara nga ana e Republikës së Maqedonisë të cilat afirmojnë çështjet që lidhen me të rinjtë dhe ajo është në pajtim me dokumentet e tjerë strategjik me interes, të miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë.



## QASJA GJATË HARTIMIT TË STRATEGJISË

Bazuar në parimet e pjesëmarrjes, ndërsa duke u mbështetur veçanërisht në “Kartën Evropiane për pjesëmarrje të të rinjve në jetën lokale dhe regjionale” dhe në “Kodeksin e praktikave të mira në pjesëmarrjen në sektorin civil në procesin e krijimit të politikave”, procesi i hartimit të Strategjisë për të rinj 2016-2025 nisi me organizimin e konferencës nacionale në të cilën më se qindra përfaqësues të organizatave dhe institucioneve të të rinjve shënuan fillimin e procesit të përgatitjes së kësaj strategjie.

Si bazë për të nxitur këtë proces është hulumtimi për trendët e të rinjve zbatuar nga ana e Institutit të hulumtimeve sociologjike dhe politike-juridike në periudhën shtator dhjetor 2014.

I tërë procesi i krijimit të Strategjisë nacionale për të rinj nisi në shkurt të vitit 2015 dhe u zhvillua në shumë faza, të cilat përfshinë thirrjen publik për pjesëmarrje në grupet punuese tematike, ku çdo shoqatë e qytetarëve, grupeve jo formale ose individëve patën mundësi të zgjedhin se në cilat fusha tematike kanë dëshirë të përfshihen aktivisht. Nga

mesi i prillit filluan takimet të grupeve punuese në kuadër të fushave parësore të strategjisë, ndërsa deri nga mesi i shtatorit u mbajtën katër apo pesë punëtori në çdo fushë që të definohen sfidat kryesore me të cilat ballafaqohen të rinjtë, si dhe objektivat afatgjate për t'u përballur me këto sfida. Faza e tretë e procesit u zhvillua në muajt tetor dhe nëntor kur u mbajtën 12 debate publike anë e mbanë shtetit, ndër të cilat edhe debati përfundimtar publik në Shkup, në të cilin morën pjesë më se 130 përfaqësues të institucioneve shtetërore, shoqata të qytetarëve, këshilla lokale të të rinjve, grupe jo formale dhe individë. Hartimi i strategjisë mundësoi përfshirje të një spektri të gjerë të përfaqësuesve të të rinjve ndër të cilët pjesëmarrje më aktive kishin anëtarët e organizatave të të rinjve dhe përfaqësues të këshillave lokale të të rinjve si dhe persona të emëruar nga ana e institucioneve shtetërore. Nëpërmjet takimeve konsultuese në nivel nacional dhe lokal dhe nëpërmjet metodologjisë së shfrytëzuar, konsiderojmë se ky dokument është ndër të rrallët në Evropën Juglindore nga aspekti i përfshirjes, duke marrë parasysh edhe instrumentet e përpunuara në mënyrë specifike të mjeteve sociale, nëpërmjet të cilave një numër i konsiderueshëm i të rinjve i dhanë mendimet dhe propozimet e veta.



*Hartimi i strategjisë mundësoi përfshirje të një spektri të gjerë të përfaqësuesve të të rinjve ndër të cilët pjesëmarrje më aktive kishin anëtarët e organizatave të të rinjve dhe përfaqësues të këshillave lokale të të rinjve si dhe persona të emëruar nga ana e institucioneve shtetërore*





## TË RINJTË E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SOT

Strategjia për të rinj 2005 -2015 për herë të parë në Republikën e Maqedonisë e hapi në mënyrë sistematike çështjen e të rinjve, në atë mënyrë që nuk ishte parë deri atëherë- në raport me të drejtat dhe nevojat e tyre, duke proklamuar me këtë rast një varg vlerash dhe qasjesh evropiane. Në këtë mënyrë kjo strategji i bëri me vlerë konstitucionale konceptet e pjesëmarrjes, përforsimit, informimit, por në radhë të parë njohtjen dhe respektimin e të drejtave të tyre.

Edhe pse relativisht ambicioze dhe gjithëpërfshirëse, Strategjia 2005-2015 për herë të parë i artikuloi dhe i bashkoi përpjekjet e institucioneve dhe sektorit qytetar dhe në këtë mënyrë krijoi hapësirë edhe për zhvillimin e një grupi kritik të të rinjve dhe organizatash të të rinjve të cilët sot janë shtytës kryesor në luftën për të drejtat e të rinjve. Në periudhën që kaloi ishim dëshmitar të iniciativave të para për implementimin e arsimit jo formal, punës rinore, stimulimin dhe rregullimin e punës vullnetare, zhvillimin e strategjive lokale për të rinj, sigurimin për qasje në programet evropiane dhe mbështetje për mobilizim në punë dhe arsimim dhe më një varg mjedesh të tjera dhe të proceseve evropiane të krijuar për të avancuar pozitën e të rinjve në shoqëri. Sfidat që qëndron para kësaj strategjie të re është që të jemi të bindur se të gjitha këto procese do të kenë përfshirje sistematike dhe institucionale me qëllim që të kontribuojnë në mënyrë efektive ndaj sfidave të ndryshme me të cilat ballafaqohen sot të rinjtë në Republikën e Maqedonisë.

Një nga problemet kryesore me të cilat ballafaqohen sot të rinjtë në Republikën e Maqedonisë është shkalla e lartë e papunësisë së të rinjve, e cila në vitin 2015 për të rinjtë të grupmoshës 15-24 vjeç ishte 48,2%.<sup>1</sup> Papunësia e të rinjve është një problem që lidhet ngushtë me gjendjen financiare si dhe me mirëqenien sociale dhe ndikon në një varg çështjesh tjera të lidhura me cilësinë e jetës. Në raport me arsimimin, në periudhën prej vitit 2010 deri 2014 shënojmë largim të pakët nga shkolla, përparim ky tek numri i të rinjve

të cilët kryejnë shkollën e mesme si dhe numri i personave deri në moshën 34 vjeç të cilët e rrumbullakojnë arsimin e lartë<sup>2</sup>. Megjithatë këto numra ende janë në nivel të ulët nga ajo që dëshirohet, si dhe nga proceset e vendeve të cilat janë anëtare të BE-së. Momentalisht brengosë edhe numri i NEET të rinjve (të rinj të cilët nuk janë përfshirë në arsim, punë ose stërvitje), që në vitin 2013 përbënte thuhajse 30%<sup>3</sup>.

Të gjitha këto çështje ndikojnë në shprehjet dhe mundësitë të cilat i kanë të rinjtë dhe që i shfrytëzojnë, por edhe në aspektet e tjera të rëndësishme të qëndrimit aktiv ndaj shëndetit, kulturës dhe sportit. Së fundmi do të theksonim edhe çështjet lidhur me pjesëmarrjen e rinisë dhe të informimit, që paraqet faktorin e rëndësishëm për të gjithë pjesëmarrësit të cilët punuan në këtë strategji, dhe të cilat janë thelbësore për formimin e çdo të riu si subjekt aktiv dhe si faktor i barabartë në të gjitha proceset shoqërore.

Pikërisht këto çështje janë baza në të cilën do të përqendrohet strategjia 2016-2025, në drejtim të krijimit dhe lehtësimit të ndërhyrjeve për tejkalimin e këtyre problemeve, në radhë të parë nëpërmjet qasjeve dhe instrumenteve të cilat tanimë janë konfirmuar si efektive në nivelin nacional dhe evropian.

Me këtë rast veçanërisht është e rëndësishme që intervenimet e parapara me këtë strategji të jenë të pranishme për të gjithë të rinjtë në Republikën e Maqedonisë në mënyrë të barabartë, veçanërisht të rinjtë e kategorive të ndryshme të cilës pritet që aktorët kryesor të realizimit të kësaj strategjie t'i kushtojnë vëmendje të posaçme.

*Papunësia e të rinjve është një problem që lidhet ngushtë me gjendjen financiare si dhe me mirëqenien sociale dhe ndikon në një varg çështjesh tjera të lidhura me cilësinë e jetës*



<sup>2</sup> IBID

<sup>3</sup> Hyrja e të rejave dhe të rinjve në tregun e punës në Republikën e Maqedonisë ë Organizata Ndërkombëtare e Punës ë Korrik 2013.

<sup>1</sup> Enti Shtetëror i Statistikave (nr,02. 1.15,32) të 11,12,2015



*Edhe pse relativisht ambicioze dhe gjithëpërfshirëse, Strategjia 205-2015 për herë të parë i artikuloi dhe i bashkoi përpjekjet e institucioneve dhe sektorit qytetar dhe në këtë mënyrë krijoi hapësirë edhe për zhvillimin e një grupi kritik të të rinjve dhe organizatash të të rinjve të cilët sot janë shtytës kryesor në luftën për të drejtat e të rinjve*

## VIZIONI 2025

Të rinjtë janë pjesëmarrës të pavarur, të mëvetëshëm, aktiv, të barabartë, të informuar dhe progresiv në të gjitha domenet të shoqërisë dhe në tërësi e zhvillojnë potencialin e tyre si qytetarë me përgjegjësi të cilët i gëzojnë të drejtat dhe liritë themelore.

Të rinjtë kanë mundësi të barabarta pa marrë parasysh dallimet dhe janë përfshirë esencialisht në procesin e marrjes së vendimeve, me ç'rast i zhvillojnë potencialet e tyre dhe aktivisht kontribuojnë në zhvillimin e përgjithshëm dhe mirëqenien e Republikës së Maqedonisë.



## PRIORITETET STRATEGJIKE

1. Ofrimi i mundësisë për standard më të mirë jetësor dhe mundësi të barabarta për jetë cilësore.
2. Krijimi i kushteve për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive fundamentale dhe integrimi sistemor dhe ndërveprimi i kategorive të ndryshme të të rinjve.
3. Krijimi i mundësive për përfshirjen e të rinjve në ndjekjen dhe sendërtimin e politikave dhe vendimeve që kanë të bëjnë me ata.
4. Qasje e barabartë në arsimimin cilësor dhe format e tjera të zhvillimit personal dhe profesional.

## PËRCAKTIMET E VALORIZIMIT TË STRATEGJISË

Duke marrë parasysh anën komplekse të jetesës në shoqërinë e sotshme dinamike si dhe sfidat specifike me të cilat ballafaqohen të rinjtë si pjesë përbërëse e zhvillimit dhe krijimit të tyre, Strategjia nacionale për të rinj në Republikën e Maqedonisë i ka parasysh këto vlera si synim i përgjithshëm dhe përcaktim esencial të këtij dokumenti:

- ▲ **PESËMARRJE** - Të rinjtë do të jenë faktorë aktiv dhe partnerë kryesorë në të gjitha proceset të zhvillimit dhe ndërtimit të shoqërisë demokratike dhe progresive. Pjesëmarrja (participimi) do të thotë krijim i mundësive për përfshirje të vërtetë dhe të rëndësishme të grupeve të ndryshme të të rinjve dhe të rejave në proceset e marrjes dhe implementimit të vendimeve në të gjitha nivelet dhe në të gjitha aspektet të jetës shoqërore që i preokupojnë ata.
- ▲ **PËRFORCIM** - Çdo përfshirje dhe bashkëpunim me të rinjtë do të shihet si mundësi e vetme për zhvillimin dhe ndërtimin e kapaciteteve të tyre dhe përforcim i tyre më qëllim të marrjes së rrolit të rëndësishëm në jetën e tyre personale dhe në shoqëri në tërësi.

- ▲ **ZHVILLIM AUTENTIK PERSONAL DHE PROFESIONAL** - Të rinjtë janë individë unik të cilët janë në proces intensiv të të mësuarit dhe të zhvillimit. Obligimi i ynë është që t'u mundësojmë të rinjve arsim dhe mundësi dhe përvoja jetësore të cilat do të kontribuojnë në realizimin e tërësishëm të potencialeve të tyre, duke kultivuar specifikat dhe dallimet e tyre individuale.
- ▲ **POLITIKA GJITHËPËRFSHIRËSE SOCIALE** - Integrimi social dhe përfshirja paraqet minimum dhe kushtin e domosdoshëm pa të cilën nuk mund të sigurohet zhvillimi integral i çdo të riu, si dhe të drejtë themelore që duhet ta gëzojnë të gjithë të rinjtë.
- ▲ **MULTIKULTURALIZMI** - Multikulturalizmi është karakteristikë kryesore e shoqërisë sonë dhe do të shihet si burim dhe vlerë potenciale shtesë e zhvillimit në të gjitha sferat e veprimit shoqëror.





▲ **IMPLEMENTIMI I STRATEGJISË PËR TË RINJ DO TË BAZOHET NË PARIMET E:**

**Barazisë dhe gjithëpërfshirjes** – Duke parë se grupeve të ndryshme të të rinjve u nevojiten qasje dhe forma të ndryshme të përkrahjes me qëllim të sigurimit të qasjes së njëjtë për shfrytëzimin e mundësive që ekzistojnë.

**Përgjegjësisë dhe llogaridhënies** – Kjo strategji është dokument i cili do të gjallërohet vetëm nëpërmjet transparencës, përgjegjësisë dhe llogaridhënies të atyre që e zbatojnë. Këto janë në radhë të parë institucionet të cilat janë të ngarkuara me zbatimin e saj, por edhe të gjithë atyre që punojnë për mirëqenien e të rinjve, në radhë të parë organizatat qytetare, shoqatat e të rinjve, bashkësia ndërkombëtare, prindërit dhe profesionistët e ndryshëm të cilët punojnë me të rinjtë.

**Bashkëpunimit dhe partneritetit** - Sfidat të cilat qëndrojnë para të rinjve janë komplekse dhe i takojnë sektorëve të shumtë, dhe modeli i vetëm që do të mundësojë tejkalimin e tyre është bashkëpunimi ndër sektorial dhe aspekti kompleks i përpjekjeve për implementimin e zgjidhjeve të propozuara. Është e nevojshme që të ndërtohen partneritete ndërmjet institucioneve dhe organizatave qytetare të të rinjve dhe të atyre që punojnë me të rinjtë që të sigurohet pjesëmarrja aktive e të rinjve dhe përfshirja adekuate e qëndrimeve të tyre gjatë zgjidhjes së problemeve.

**Profesionalizmit** - Realizimi i strategjisë së të rinjve do të nënkuptojë kryerjen e detyrave individuale dhe përgjegjësisë me nivel të lartë të kompetencës, konsekuencës dhe të integritetit profesional dhe personal. Profesionalizëm do të thotë edhe cilësi e lartë në punë, etikë të fortë punuese dhe përkushtim ndaj përparimit të vazhdueshëm të rezultateve dhe proceseve.



## FUSHAT TEMATIKE

### Fusha tematike: PJESËMARRJE RINORE

Pjesëmarrja efektive e të rinjve paraqet të drejtën por edhe mundësinë që të rinjtë dhe të rejtat të përfshihen në krijimin, sjelljen dhe realizimin e politikave që janë në interes të tyre. Gjithashtu, pjesëmarrja e të rinjve është proces i krijimit të mundësive që ato të jenë pjesë e rëndësishme e procesit dhe të ndikojnë në krijimin dhe sendërtimin e politikave të cilat kontribuojnë për zhvillimin e strategjive dhe programeve. Këto mundësi krijohen nëpërmjet zhvillimit të spektrit të gjerë të mekanizmave formal dhe joformal për pjesëmarrje të të rinjve, nga këshillat lokale deri te grupet e fokusit, nga konsultimet rrjedhëse për politikatat e të rinjve, deri te projektet të drejtuar nga të rinjtë.

Praktikat e instaluar, mosekzistimi i trupave përfaqësuese, informimi dhe edukimi i ulët i të rinjve për të drejtën e pjesëmarrjes fletë për përjashtimin e të rinjve nga këto procese dhe në shkaqet që shpien në apati. Përfaqësimi i të rinjve në institucione nuk është në nivelin e kënaqshëm, por edhe atje ku hasen ata rrallë ose pak janë përfshirë në marrjen e vendimeve. Në nivelin lokal, hasen forma të organizimit rinor, si dhe dokumente strategjike për të rinj në disa komuna, por nuk ekziston qasje e unifikuar që praktikohet çdo kund. Gjithashtu, institucionet lokale vetëqeverisëse dhe qeveritare nuk ndajnë mjete të mjaftueshme për nevojat e të rinjve dhe për realizimin e ideve të tyre dhe shumë pak kontribuojnë në nxitjen e vullnetarizmit tek të rinjtë, edhe pse pjesa më e madhe e popullatës së re e përkrahë angazhimin e këtillë të të rinjve si përgatitje që të hynë më të përgatitur në vendet e tyre të ardhshme të punës.

Sfidat kryesore në lëmin e pjesëmarrjes së të rinjve lidhen në qëndrimet e të rinjve se ata janë përfshirë vetëm pjesërisht gjatë krijimit të politikave, si dhe se ata më tepër janë përfshirë në ndihmën gjatë kryerjes së obligimeve shkollore të moshatarëve ose të shokëve, në vend se të marrin pjesë vullnetarisht në organizata jo qeveritare dhe që haset shumë rrallë.

Gjithashtu, të rinjtë që janë anëtarë në shoqata të qytetarëve konsiderojnë se është e vogël përqindja e të rinjve të cilët nuk janë anëtarë në asnjë organizatë dhe se një përqindje e konsiderueshme e të rinjve nuk interesohen aspak për politikë.

Këto sfida kryesore në aspekt afatgjatë mund të shkaktojnë apati të popullatës së rinisë, të ndikojnë në cilësinë e arsimit, të frymëzojnë qytetarë pasiv dhe në tërësi të ndikojnë në cilësinë e jetës së të rinjve. Në pajtim me sfidat kryesore të konfirmuara, me këtë strategji parashihen objektiva përkatëse afatgjate dhe masa specifike nëpërmjet të cilave do të vepohet në zgjidhjen e problemeve të përmendura.

### OBJEKTIVAT AFATGJATË

**OBJEKTIVI 1:** Numri i shtuar i iniciativave dhe shoqatave burimore rinore

#### Masat sipas objektivit 1:

1. Promovimi i aktivizimit të të rinjve dhe i përfitimeve në sistemin shkollor dhe jashtë shkollor dhe të të rinjve me mundësi të pakta.
2. Organizimi i prezantimeve për promovimin e aktivizimit të të rinjve të mbështetur nga institucione relevante.
3. Programe për mbështetje dhe edukim në nivel nacional dhe lokal.
4. Sigurimi i mbështetjes për edukim të të rinjve për përfitimet dhe mundësitë e iniciativave jo formale.
5. Sigurimi i një procesi të gjerë konsultues në nivel nacional dhe lokal gjatë krijimit të politikave publike që i preokupojnë të rinjtë.



**OBJEKTIVI 2:** Institucionet, organizatat dhe të rinjtë kanë aktivitete të rregullta, të vazhdueshme dhe të përbashkëta në pajtim me interesat e të rinjve.

**Masat sipas objektivit 2:**

1. Analiza e gjendjes ekzistuese dhe të praktikave pozitive për funksionimin e trupave bashkë menaxhuese në nivel evropian të përpiluar në bashkëpunim ndërmjet institucioneve përkatëse dhe organizatave qytetare.
2. Proces të gjerë konsultues gjatë krijimit të trupave bashkë menaxhuese si dhe në krijimin e politikës për funksionimin e trupit bashkë menaxher (kompetencat dhe planet strategjike).
3. Instalimi i mekanizmit bashkë menaxhues për marrje të vendimeve dhe koordinim gjatë zbatimit të aktiviteteve, me anëtarësi proporcionale të institucioneve kompetente, organizatave qytetare dhe formave të tjera të bashkimit të të rinjve.

**OBJEKTIVI 3:** Sigurimi i mbështetjes financiare nga ana e autoriteteve lokale dhe nacionale në drejtim të nxitjes së pjesëmarrjes së të rinjve.

**Masat sipas objektivit 3:**

1. Analiza e implikimeve buxhetore të strategjisë në nivel nacional dhe lokal, e bërë në bashkëpunim ndërmjet institucioneve kompetente dhe organizatave qytetare,
2. Përkufizimi i mjeteve të posaçme financiare dedikuar zbatimit të strategjisë nacionale.
3. Proces i gjerë konsultues gjatë krijimit të trupit bashkë menaxhues si dhe gjatë krijimit të politikës për funksionimin e trupit bashkë menaxhues (kompetencat dhe planet strategjike),
4. Instalimi i mekanizmit bashkë menaxher për marrje të vendimeve dhe koordinim gjatë zbatimit të aktiviteteve, me anëtarësi proporcionale të insti-

tucioneve kompetente, organizatave qytetare dhe formave të tjera të bashkimit të të rinjve.

5. Programe për bashkëpunim ndërmjet organizatave qytetare dhe institucioneve kompetente për punë në projektet evropiane.
6. Përkufizimi i linjës së veçantë buxhetore për instalimin e fondit të ri programues për mbështetje të drejtpërdrejtë të të rinjve dhe format e bashkimit të të rinjve.

**OBJEKTIVI 4:** Sigurimi i përqendrimit të të rëndësishëm institucional të të rinjve nëpërmjet Agjencisë për të rinj dhe sport

**Masa sipas objektivit 4:**

1. Programi për ndërtimin e kapaciteteve të institucioneve kompetente për implementimin e gjithanshëm të politikave rinore.
2. Garantimi i pjesëmarrjes së institucioneve kompetente në procese të cilat zhvillohen në nivelin evropian dhe global.
3. Proces i gjerë konsultues gjatë krijimit të politikës dhe gjatë implementimit të politikave rinore në nivel nacional dhe lokal.
4. Instalimi i mekanizmit bashkë menaxhues për marrje të vendimeve dhe koordinim gjatë zbatimit të aktiviteteve, me anëtarësi proporcionale të institucioneve kompetente, organizatave qytetare dhe formave të tjera të bashkimit të të rinjve
5. Sigurimi i burimeve hapësinore dhe teknike nga ana e institucioneve për zbatimin e politikave rinore.



**OBJEKTIVI 5:** Sigurimi i burimeve përkatëse për implementimin e politikave rinore dhe mekanizmave për pjesëmarrje rinore.

#### Masa sipas objektivit 5:

1. Hulumtimi (krahasimi me situatat e tjera relevante në vendet fqinje dhe më gjerë (Serbi etj).
2. Vizita studimore në ministritë gjegjëse në Evropë (të kuptuarit e punës së institucioneve të këtilla dhe kompetencave të tyre).
3. Hartimi i hartave me resurse (çfarë resurseash disponohen për krijimin e një ministrie të këtillë, në radhë të parë të resurseve financiare).
4. Proces i hapur për hartimin e kartave të kompetencave të kësaj ministrie (grupet e fokusit për përkufizimin e kompetencave të kësaj ministrie që do t'i përfshijë institucionet kompetente por edhe organizatat jo qeveritare të cilat punojnë me të rinjtë.
5. Krijimi i sistemit bashkë-menaxhues për marrjen e vendimeve.

Bartës të masave në lëmin e Pjesëmarrjes rinore janë: Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, Qeveria e Republikës së Maqedonisë, Agjencia për të rinj dhe sport, Ministria e pushtetit lokal, Ministria e arsimit dhe shkencës dhe Ministria e punës dhe politikës sociale.

#### Fusha tematike: INFORMIMI RINOR

Informimi rinor më shpesh shihet si sistem i aktiviteteve nëpërmjet të cilave transmetohen informata deri te të rinjtë. Në këtë sistem të aktiviteteve duhet të sigurohet qasje në informacione të cilat janë të lidhura me të rinjtë, ndërsa sigurimi bëhet nëpërmjet të institucioneve në nivel qendror dhe lokal. Më shpesh informimi rinor nënkuptohet si sistem për dhënien e shërbimeve të specializuara informative, që janë me interes për të rinjtë. Veçanërisht për këtë proces është që ai të rezultojë me informacione cilësore tek të cilët të rinjtë kanë qasje të lirë dhe të gjerë. Si pasojë e kësaj pikëpamjet e të rinjve janë se informimi rinor është proces qytetar i këmbimit të informacioneve, përkatësisht proces komunikues ndërmjet institucioneve dhe të rinjve, të rinjve me të rinjtë, por edhe të rinjtë me institucionet.

Sfidat kryesore në këtë fushë janë të lidhura me informacionet e limituar për të rinjtë, mënyra e prezantimit të informacioneve të cilat nuk janë me gjuhën e afërt të të rinjve si dhe jo gjithmonë shfrytëzimi adekuat i medimeve sociale dhe mënyra e prezantimit të informatës që nuk është në gjuhën miqësore rinore. Të rinjtë gjithashtu konsiderojnë se nuk ekziston strukturë e informimit rinor nëpërmjet së cilët në një vend do të gjendeshin informacionet që janë me interes për të rinjtë, si dhe mosekzistimi i praktikës (vetëdijes) për ndarjen e informacioneve të të rinjtë. Këto sfida kryesore mund të shkaktojnë interes të dobët të të rinjve për ndjekjen e medimeve tradicionale, rritjen e mosbesimit tek institucionet që punojnë me çështje të cilat janë me interes për të rinjtë, përmbajtjet jo adekuate dhe jo përkatëse të medimeve mund të ndikojnë negativisht në zhvillimin e të rinjve, të rinjtë në mungesë të informacioneve me kohë dhe të sakta mund të bëhen apatik ndaj shoqërisë.

Në pajtim me sfidat e përcaktuara kryesore, me këtë strategji parashihen objektiva përkatëse afatgjatë dhe masa specifike.



## OBJEKTIVAT AFATGJATË

**OBJEKTIVI 1:** Qasje dhe transparencë në informacione me interes për të rinjtë për realizimin e interesave të tyre.

### Masa sipas objektivit 1:

1. Analiza dhe përkufizimi i gjendjes dhe praktikave të ARS.
2. Shënimi i kartës së grupeve të fokusit dhe instalimi i metodave funksionale për komunikim me grupet e synuara.
3. Krijimi i programeve dhe planeve të veprimit për implementim në përbërje të njësisë për informim të të rinjve.
4. Zbatimi i sistemit efikas dhe efektiv për monitorim dhe kontroll të programit të njësisë.
5. Analiza dhe hulumtimi i dokumenteve ekzistuese dhe praktikave të vendeve në BE dhe rajon.
6. Hartimi projekt/draft dokumentit (policy documents).
7. Miratimi i dokumentit për informim transparent rinor.
8. Monitorimi dhe valorizimi i implementimit të “dokumentit me politika”.
9. Përgatitja e projektit për informim rinor dhe aktivitetet për popullarizimin e tij.
10. Informimi dhe mbështetja e personelit në medime.
11. Hulumtimi i qëndrimeve të publikut për programet e radios dhe televizionit për temat dhe përmbajtjet dedikuar të rinjve.

**OBJEKTIVI 2:** Krijimi i strategjisë së komunikimit për koordinim ndërinstitucional për informim të të rinjve.

### Masat sipas objektivit 2:

1. Analiza e funksionalitetit dhe mangësive të kanaleve ekzistuese për komunikim ndërmjet institucioneve dhe të rinjve.
2. Formimi i grupeve punuese me pjesëmarrje të organizatave rinore për përpunimin e strategjisë së komunikimit.
3. Përkufizimi i kanaleve funksionale për komunikim ndërmjet institucioneve - organizatave rinore - dhe të rinjve (operim) .
4. Shënimi në kartë i kanaleve ekzistuese në sistemin elektronik të informimit.
5. Vendosja e fushës së veçantë të dukshme (kategori e veçantë) për informimin e të rinjve në ueb-faqet e institucioneve dhe organizatave.
6. Rrjetëzimi dhe platforma interneti të organizatave dhe institucioneve në prezantimin e informacioneve për të rinjtë.
7. Përpunimi i aplikimeve online për informim të të rinjve.
8. Identifikimi i trupit koordinues.
9. Zgjedhja e anëtarëve .
10. Krijimi i programeve dhe procedurave .
11. Monitorimi dhe evoluimi i punës.





**OBJEKTIVI 3:** Është instaluar sistemi për informim të të rinjve në nivel lokal dhe nacional me mekanizma për zhvillim të qëndrueshëm (kapacitete të përforcuara, shtim i cilësisë dhe sasisë).

#### Masat sipas objektivit 3:

1. Nisja e iniciativës për komunikim (ose për ngritjen e rrjetit) me institucionet dhe organizatat e të rinjve.
2. Mbajtja e takimeve të rregullta katër herë në vjet për koordinim dhe komunikim.
3. Përgatitja e orientimeve konkrete për bashkëpunim të përbashkët në fushën e informimit rinor.
4. Përcaktimi i personave për informim rinor në organizata dhe institucione.
5. Stërvitja e personave të përcaktuar për aftësim profesional për informim të të rinjve.
6. Transferimi i njohurive të personave të aftësuar tek bashkëpunëtorët e tyre.
7. Organizim i stërvitjes së punëtorëve informues rinor.
8. Analizë e kapaciteteve financiare të organizatave dhe të mundësive financiare të institucioneve.
9. Ndarja e mjeteve nga fondi nacional dhe lokal për projekte për informim rinor.

Bartës të masave në lëmin e Informimit rinor janë Agjencia e Shërbimeve Audio dhe Mediumeve Audio-vizuale, Agjencia e Rinisë dhe Sporteve dhe njësitë e vetëqeverisjes lokale.

#### Fusha tematike: PUNA RINORE LOKALE

Puna lokale rinore paraqet procesin e organizuar sistematik të edukimit dhe mbështetjes së zhvillimit autentik të të rinjve me qëllim realizimi të potencialit të tyre personal, social dhe shoqëror të tërësishëm. Kjo është e lidhur drejtpërdrejt me zhvillimin e bashkësisë lokale nëpërmjet së cilës të rinjtë jo vetëm që bëhen subjekt aktiv në procesin e zhvillimit të tyre por edhe faktorë aktiv në jetën e bashkësisë.

Në Republikën e Maqedonisë sistemi i punës lokale rinore (PLR) ende është në fillim të zhvillimit të vet. Kjo për fat të keq ende nuk është përcaktuar si një nga komponentët kyç në procesin e edukimit, mbrojtjes dhe zhvillimit të të rinjve dhe si e tillë zbatimi i saj në sistemin arsimor-edukativ dhe tipi i aktiviteteve rinore që kanë qasje për të rinjtë (sport, stërvitje, punëtori, kampe, shkëmbime, aktivitete jashtë shkollore, aktivitete vullnetare etj), në masë të madhe mbështetet tek ajo që është siguruar nga ana e organizatave qytetare. E gjithë kjo shtron një varg pyetjesh nga aspekti i mos shfrytëzimit të potencialit të punës rinore për mbështetje dhe afirmim të zhvillimit të tyre personal, social dhe profesional, dhe deri te mungesa e kontrollit dhe sigurimit të zbatimit e saj të tanishëm.

Sfidat kryesore në këtë fushë me të cilat ballafaqohen të rinjtë lidhen me faktin se puna rinore nuk shihet si instrument kryesor për të ndihmuar zhvillimin pozitiv personal dhe social të të rinjve. Puna rinore nuk është rregulluar, standardizuar dhe integruar formalisht, si pjesë e sistemit të edukimit, arsimimit dhe mbrojtjes së të rinjve dhe ajo nuk është e kapshme në mënyrë të barabartë për të rinjtë në rajone të ndryshme të vendit.

Në pajtim me përcaktimet e sfidave kryesore në këtë fushë parashihen objektiva afatgjate përkatëse dhe masa specifike nëpërmjet të cilave do të vepohet në zgjidhjen e problemeve të përmendura.



**OBJEKTIVI 1:** Identifikimi i punës rinore si instrument kryesor për të ndihmuar zhvillimin pozitiv personal dhe social të të rinjve.

**Masat sipas objektivit 1:**

1. Promovimi sipas konceptit dhe zbatimit të punës rinore nëpërmjet fushatave, ngjarjeve publike, ofertës së gjerë të aktiviteteve të punës rinore dhe shembujve pozitiv nga vendet tjera.
2. Njohja dhe edukimi të kuadrove arsimor dhe të profesionistëve të tjerë të cilët punojnë me të rinjtë (pedagogë, psikologë, punëtorë social e tjerë) me konceptin dhe implementimin e potencial të punës rinore.
3. Përfshirja e njohurive themelore me punën rinore në programet e arsimit të profesorëve që punojnë punë zhvillimore me të rinjtë (arsimtarët, psikologët, pedagogët, punëtorët social etj.).
4. Promovimi i rrëfimeve të suksesshme për përdorimin dhe afinitetet potenciale të punës rinore për përkrahje të zhvillimit personal të të rinjve.
5. Promovimi i punës rinore dhe përdorimi i saj për të përkrahur kategoritë e prekura të të rinjve dhe në situata të ndryshme të jetës.
6. Promovimi i përvojave evropiane dhe implementimi i punës rinore.
7. Promovimi dhe përkrahja e organizatave qytetare të cilat bëjnë implementimin e punës rinore.
8. Ndjekja, dokumentimi dhe promovimi i rezultateve dhe arritjeve pozitive gjatë implementimit të punës rinore.

**OBJEKTIVI 2:** Identifikimi dhe rregullimi formal i implementimit dhe ofertës së punës rinore si pjesë integrale të sistemit edukativ-arsimor në vend.

**Masat sipas objektivit 2:**

1. Mbështetja e proceseve të përkufizimit të punës rinore, formave të saj, dhe zbatimi në sistemin edukativo-arsimor në nivel nacional.
2. Rregullimi dhe integrimi i punës rinore në kuadër të rregullave ekzistuese ligjore si pjesë e sistemit të arsimit, edukimit dhe mbrojtjes së të rinjve.
3. Identifikimi i profesionit punëtor rinor në kuadër të klasifikimit nacional të profesioneve.
4. Integrimi i ofertës minimale të detyrueshme të punës rinore si pjesë e aktiviteteve të të rinjve në kuadër të komunave.
5. Përkrahje e proceseve të participimit dhe konsultimit në përkufizimin e Kornizës nacionale të cilësisë së punës rinore.
6. Përkufizimi i Portfolios nacionale të punëtorëve nacional me kompetenca dhe mbështetje minimale të kuadrove të cilët bëjnë implementimin e punës rinore.
7. Zhvillimi dhe zbatim i kodeksit të etikës në punën rinore profesionale dhe vullnetare.



**OBJEKTIVI 3:** Realizimi i ofertës cilësore dhe të kapshme të punës rinore në territorin e çdo komune.

### Masat sipas objektivit 3:

1. Mbështetje e proceseve të identifikimit dhe ndërtimit të kapaciteteve të punëtorëve rinore për implementim të punës cilësore me të rinjtë.
2. Sigurimi i potencialeve për edukim profesional dhe rikualifikim të punëtorëve rinor momental dhe të ardhshëm në kuadër të sistemit të arsimit formal dhe jo formal.
3. Sigurimi i kapaciteteve njerëzore përkatëse për implementimin e punës rinore në territorin e çdo komune.
4. Përkrahja e autoriteteve lokale në sigurimin e hapësirës dhe kushteve për implementim të punës rinore në territorin e çdo komune.
5. Promovimi i bashkëpunimit ndërmjet organizatave qytetare dhe institucioneve lokale për ofrim të punës rinore në territorin e çdo komune.
6. Sigurimi i ofertës së punës rinore në pajtim me nevojat e të rinjve në nivel lokal.
7. Integrimi i ofertës së punës rinore si pjesë e strategjive lokale për të rinjtë.
8. Përfshirja e të rinjve si partner aktiv në procesin e implementimit të punës rinore.

Bartës të masave të parapara me këtë fushë janë Agjencia e të Rinjve dhe Sportit, Ministria e Vetëqeverisjes Lokale, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale dhe Njësitë e Pushtetit Lokal.

### Fusha tematike: ARSIMI

Arsimi është e drejtë fundamentale njerëzore. Ai i mundëson fëmijëve, të rinjve dhe të moshuarve aftësinë për gjykim të argumentuar, të bëjnë zgjedhje dhe të përmirësojnë jetën. E mënjanon qarkun e mbyllur të varfërisë dhe është element kuç i zhvillimit ekonomik dhe social. Arsimimi duhet të shihet si një fushë shumë dimensionesh që ka të bëjë me shumë target grupe dhe në vete përfshin shumë nivele dhe qasje. Nga aspekti i Strategjisë së ardhshme nacionale për të rinj në shqyrtimin e mëtejshëm të situatave dhe përkufizimin e prioritetëve dhe veprimeve me rëndësi të veçantë është që të trajtohen në mënyrë të barabartë: arsimimi i mesëm dhe i lartë, arsimimi jo formal cilësia, qasja dhe integrimi i procesit arsimor.

Sistemi arsimor në Republikën e Maqedonisë është një proces i vazhdueshëm i reformave. Në periudhën e kaluar janë marrë aktivitete në fushën e politikave arsimore si në arsimin e mesëm ashtu edhe në atë të lartë me të cilat shteti ynë synon të arrijë standarde ndërkombëtare për arsimin cilësor. Nga ana tjetër një proces i këtillë i vazhdueshëm i reformave dhe hyrja nga një reformë në tjetrën nuk lë hapësirë të mjaftueshme për vlerësimin e efekteve të implementimit të modeleve të caktuara dhe qasjeve arsimore, ndërsa njëkohësisht bën edhe ngushtimin e hapësirës për përfshirje esenciale të të gjitha palëve të prekura, veçanërisht të shfrytëzuesve të drejtpërdrejtë të këtyre reformave të rinjve të cilët janë në procesin arsimor.

Nevojat e detektuar të të rinjve në kuadër të hulumtimeve relevante me të cilat bëhet analiza e gjendjes<sup>4</sup>, si në arsimin e mesëm ashtu edhe në atë të lartë, dhe gjendja e përgjithshme e të rinjve si target grup i veçantë bëjnë thirrje për deponimin e përpjekjeve plotësuese me qëllim të përmirësimit të arsimit që u ofrohet të rinjve. Nevojat e këtilla kanë të bëjnë në radhë të parë me përparimin e cilësisë së kuadrit arsimor, brendia dhe cilësia e

<sup>4</sup> Më gjerësisht për hulumtimet e konsultuara në listen referente të dokumentacionit të shfrytëzuar që është shënë si shtesë e strategjisë.



përmbajtjeve mësimore, zhvillimi dhe instalimi i teknikave novatore dhe metodave të mëimit, qasje të barabartë të të rinjve në procesin e arsimit, si dhe përfshirje sa më të madhe sipas moshës, gjinisë dhe përkatësisë etnike. Me këtë rast është me rëndësi të përmendet se nga aspekti i kësaj strategjie e cila si target grup ka të rinjtë, me rëndësi esenciale është përfshirja e të rinjve në procesin e zhvillimit të arsimit cilësor dhe integritetit të qëndrimeve dhe nevojave të tyre si në nivelin e politikave ashtu edhe në praktikë.

### OBJEKTIVAT AFATGJATË

**Segmenti: Aplikimi i metodave dhe teknikave mësimore, qasja arsimore dhe cilësia e kuadrit arsimor.**

**OBJEKTIVI 1:** Të avancohen programet mësimore dhe teknikat në arsimin fillor, të mesëm dhe të lartë. Duke përfshirë edhe praktikën mësimore në arsimin e mesëm dhe të lartë.

#### Masat sipas objektivit 1:

1. Analizë për aplikimin e mëimit praktik në arsimin e mesëm dhe të lartë.
2. Oferta e modeleve të reja ose të ndryshme të aplikueshme në praktikë, analiza e potencialeve për zgjerimin e praktikës në fusha të tjera mësimore dhe lëndëve dhe mundësia për kohë më të madhe për implementimin e mëimit praktik jashtë institucioneve arsimore në arsimin e mesëm dhe të lartë.
3. Zhvillimi i qasjes dhe kriterëve për përparimin e valorizimit të praktikës në shkollat profesionale.
4. Përparimi i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve arsimore me komunitetin e biznesit për zbatimin e mëimit praktik dhe futjen e programeve të bazuar tek nevojat e tregut të punës.
5. Zgjerimi i sistemit të mentorit në kompanitë për ndjekjen dhe stërvitjen e nxënësve gjatë implementimit të mëimit praktik.
6. Promovimi dhe përforcimi i informimit për fleksibilitetin të lëndëve zgjedhore në fakultet jashtë atij amëz, në kuadër të të njëjtit universitet, me qëllim të begatimit të njohurive dhe aftësive të studentëve për kompetencë të tyre më të madhe në tregun e punës.
7. Përgatitja e një gazete elektronike për të gjitha shkollat fillore/të mesme për informim për risitë e futura në shkolla dhe në përgjithësi në arsim.
8. Angazhim më i madh i personave ekspert në shkollat fillore dhe të mesme me qëllim që t'i kushtohet kujdes më i madh nxënësve, veçanërisht personave me nevoja të veçanta, dhe komunikim më i mirë, takime përkatëse, parandalimi i akteve të dhunës, asistencë psikologjike për fëmijët prindërit e të cilëve janë të divorcuar/të ndarë (pedagogë, psikologë, defektologë, punëtorë social/sociologë).
9. Futja e programit të aktivitetit shoqëror të nxënësve.
10. Dizajnim të përmbajtjeve dhe aktiviteteve të programeve të studentëve në arsimin e mesëm sipas rezultatit të arritur në pajtim me Kornizën nacionale të kualifikimeve arsimore të larta në përcaktimin e të cilave, kontribut do të japin edhe studentët si partnerë të barabartë në procesin e arsimit të lartë.
11. Ngritja e kulturës për pjesëmarrje aktive të të rinjve në futjen e të dhënave për përparim në karrierë në bazat e enteve të arsimit të lartë me qëllim të valorizimit të përmirësimit më efikas të cilësisë së programeve studentore.



**OBJEKTIVI 2:** Të përmirësohet cilësia, përgatitja dhe mbështetja e kuadrit arsimor në procesin arsimor-edukativ në arsimin e mesëm dhe ofrimi i mundësive për zhvillim të kuadrit në institucionet e arsimit të lartë.

#### Masat sipas objektivit 2:

1. Trajnim i vazhdueshëm për aftësimin e kuadrit adekuat dhe të ndjeshëm me qëllim që të mund t'u përgjigjet nevojave të çdo nxënësi pa marrë parasysh prapavijën e tyre.
2. Trajnim i vazhdueshëm tematik të kuadrit arsimor i cili do të jetë i përgatitur për t'iu adaptuar ndryshimeve të shpejta/ risive në shoqëri, përkatësisht në sistemin e lartë arsimor.

**Segmenti: Përfshirja dhe cilësia e programeve mësimore dhe kontrolli i cilësisë në arsim.**

**OBJEKTIVI 3:** Të përparohet dhe zbatohet në mënyrë adekuate testimi ekstern i aftësive të nxënësve si një nga mekanizmat e ndjekjes dhe kontrollit të cilësisë së arsimit.

#### Masa sipas objektivit 3:

1. Analizë e hollësishme e mënyrës ekzistuese të testimit ekstern të rezultateve të nxënësve.
2. Konsultime me nxënësit dhe realizimi i bashkëpunimit me psikologë dhe pedagogë rreth ndikimit të tyre në testim.
3. Përkufizimi i mënyrës së avancimit dhe përsosjes së tij (testimit).
4. Përkufizimi dhe zbatimi i rekomandimeve për përmirësimin e procesit të testimit ekstern.
5. Gjallërimi i akteve ligjore dhe nënligjore dhe miratimi i tyre.
6. Avancimi i aftësive të studentëve për valorizimin e programeve studimore të të gjitha cik-

leve të arsimit të lartë, në pajtim me Standardet evropiane dhe orientimet e cilësisë së arsimit të lartë (ESG).

7. Pjesëmarrje aktive e studentëve në përgatitjen e metodologjisë dhe pyetësorëve për notimin e kuadrit mësimor në arsimin e lartë.

**OBJEKTIVI 4:** Përfshirje dhe trajtim përkatës i përmbajtjeve të arsimit seksual në procesin e edukimit formal dhe joformal.

#### Masat sipas objektivit 4

1. Krijimi i platformës së gjerë (institucione arsimore, sektori qytetar, institucionet e resorëve shtetëror dhe ndërkombëtar) për zbatimin e analizës së gjendjes faktike dhe mundësive për krijimin e modelit për arsim seksual.
2. Analiza e përmbajtjeve mësimore për arsimin seksual.
3. Analiza e mundësive për zgjerimin e diturive për edukimin seksual dhe arsimim në pajtim me moshën e nxënësve.
4. Sipas analizës të bëhen plotësime të përmbajtjeve mësimore me tema të bazuara në zbulimet më të reja shkencore sipas moshës së nxënësve.
5. Implementimi i temave të caktuara nga përmbajtjet e arsimit seksual dhe të arsimimit për shembull, nga lëndët mësimore: biologji, sociologji dhe shkathtësi jetësore, ligjërata nga kuadri përkatës për lëndët e përmendura mësimore ose nga persona profesional të specializuar nga lëmi i edukimit dhe arsimimit seksual si bashkë ligjërues për tema të caktuara.
6. Intensifikimi i bashkëpunimit ndërmjet shkollave fillore dhe të mesme nga njëra anë dhe sektorit qytetar, si dhe me fakultetet përkatëse nga ana tjetër.



7. Analiza dhe valorizimi i nivelit dhe mënyra e implementimit të edukimit seksual në arsimin fillor dhe të mesëm, si pjesë përbërëse nga programet mësimore të shkathtësive jetësore dhe biologjisë.
8. Organizimi i ushtrimeve për kuadrin mësimor për temën e arsimimit të gjithanshëm seksual.

**OBJEKTIVI 5:** T'i mundësohet qasje çdo institucioni arsimor në bazat referente nga literatura bashkëkohore dhe progresive.

#### Masa sipas objektivit 5:

1. Hulumtimi dhe analiza për qasje në enciklopeditë, hulumtimet dhe teknikat botërore.
2. Krijimi i rekomandimeve për ekspansion në qasjen e bazave.
3. Përditësimi i data-bazave vetjake, ku institucionet do të shpallin punime dhe vepra nga literatura dhe shkenca.
4. Valorizimi i efikasitetit dhe shfrytëzimit të bazave të ngritura.
5. Analiza e përfshirjes së literaturës përkatëse në nivel të autorëve botëror dhe të vendit.
6. Rekomandime për plotësimin e bazave me literaturë adekuate.

**Segmenti:** Politikat arsimore, qasje dhe pjesëmarrje e të rinjve në procesin e krijimit të politikave arsimore.

**OBJEKTIVI 6:** Të konfirmohet qasja sistemore gjatë sjelljes së politikave arsimore të bazuara në analiza dhe hulumtime, por në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira, përfshirë këtu edhe të rinjtë në të gjitha fazat.

#### Masat sipas objektivit 6:

1. Përpunimi i analizës nga ana e një trupi të pavarur i cili do të hulumtojë nevojën për ndryshimin e mënyrës së sjelljes dhe zbatimit të politikave publike në arsim.
2. Përgatitja e një varg rekomandimesh për përpunimin, të bazuar në analizë dhe miratimi i tyre nga ana e kompetentëve, në konsultim me palët e preokupuara.
3. Instalimi i procesit të monitorimit ndaj zbatimit të rekomandimeve.
4. Implementimi i valorizimit kohor të paraparë dhe të planifikuar për vlerësim të efekteve të zbatimit të sistemit për marrjen e vendimeve në arsim.
5. Identifikimi dhe implementimi i standardeve dhe politikave ndërkombëtare.
6. Revizionimi i aspektit adekuat në implementimin e standardeve dhe politikave ndërkombëtare të cilat Maqedonia tanimë i ka në implementim ( p.sh. Implementimi i Sistemit të Bolonjës).
7. Përcaktimi i standardeve dhe politikave ndërkombëtare nëpërmjet përfshirjes së tyre në programin e ri të zhvillimit të arsimit ose në mungesë të tyre, në dokumentin individual strategjik.
8. Mundësimi i kushteve për krijimin e formave të pavarura dhe autonome për organizim të nxënësve dhe studentëve.
9. Mundësimi i participimit formal-juridik të nxënësve në proceset e vendimmarrjes në nivel të shkollës.



10. Avancimi i procesit të përsosjes dhe implementimit të politikave arsimore publike, përkatësisht përcaktimi i fazave dhe formave për pjesëmarrje më aktive të nxënësve, studentëve në konsultimet me organet kompetente.
11. Ngritja e kulturës për pjesëmarrje më aktive të studentëve dhe nxënësve në krijimin e politikave publike.
12. Përcaktimi dhe implementimi i metodologjisë me të cilën ndiqet përgjegjshmëria e Ministrisë dhe institucioneve të tjera shtetërore në lëmin e arsimit rreth kërkesave të parashtruara nga të rinjtë, përkatësisht nga nxënësit dhe studentët.

**OBJEKTIVI 7:** Zbatimi konsekuent dhe konzistent i politikave arsimore.

#### Masa sipas objektivit 7:

1. Përgatitja e analizës me qëllim përcaktimi të kompetencave dhe mangësive të përcaktimit preciz të kompetencave, në strukturën vertikale dhe horizontale institucionale.
2. Mbajtja e takimeve dhe konferencave me qëllim që të stimulohet bashkëpunimi ndër resorë dhe institucioneve.
3. Krijimi i grupeve të përziera punuese dhe të ekspertëve për analizë të politikave dhe krijimin e rekomandimeve.
4. Zbatimi i analizave për vlerësimin e efikasitetit të procedurave administrative, që do të përfshijë edhe vlerësimin e shkallës së plotësisht dhe të qëndrimit rreth procedurave administrative nga ana e arsimtarit, profesorit dhe kuadrit administrativ në institucionet arsimore.
5. Përcaktimi i sistemit të valorizimit të politikave arsimore dhe praktikave administrative.

6. Analiza e efektivitetit të sanksioneve, veçanërisht edhe krahasimin me metodat alternative për avancim të kënaqësisë personale të edukatorit si para supozim për përmirësimin e performancës.

**OBJEKTIVI 8:** të përshtatet kuadri juridik i arsimit joformal në pajtim me natyrën e sektorit rinor dhe me zbatimin e gjerë të standardeve të BE.

#### Masa sipas objektivit 8:

1. Zgjerimi i kriterëve për oferta të AJF të akredituar nga shteti, përkatësisht zbatimi i rekomandimeve evropiane dhe orientimet për identifikimin dhe akreditimin e arsimit jo formal, duke marrë parasysh specifikat e sektorit të rinisë.
2. Akreditimi i organizatave rinore dhe të tjerave të cilat ofrojnë arsimim jo formal.
3. Njohje, krahasim, dhe përcjellje të shkathtësive dhe njohurive nëpërmjet zbatimit të mekanizmave të ngjashëm të EUROPASS.
4. Hulumtime të rregullta për ndikimin socio-ekonomik të arsimit jo formal/
5. Përkrahje për përmirësimin e cilësisë gjatë realizimit të arsimit joformal.
6. Promovim i mëtejshëm i konceptit të arsimit joformal para partnerëve të tjerë social, veçanërisht subjektet e tregut në pjesën e njohjes së shkathtësive dhe kompetencave të arritura.

**Segmenti: Integrimi social të grupeve të marginalizuara nëpërmjet arsimit dhe kushteve për punë dhe mësim**



**OBJEKTIVI 9:** të arrihet përfshirje dhe integrim i rëndësishëm i fëmijëve dhe të rinjve me nevoja të veçanta në sistemin arsimor.

**Masat sipas objektivit 9:**

1. Stërvitja e kuadrit mësimor ekzistues dhe të shërbimeve profesionale ekzistuese dhe angazhimi i kuadrit plotësues, atje ku është i nevojshëm.
2. Bashkëpunim dhe koordinim ndër institucional dhe bashkëpunimi me OC.
3. Analiza e gjendjes ekzistuese për pasjen dhe zbatimin e teknologjive asistente.
4. Shënimi i kartës së nevojave.
5. Bashkëpunimi dhe implementimi i projekteve ndërmjet institucioneve dhe OC.
6. Stërvitja e kuadrit për zbatimin e teknologjive asistente.

**OBJEKTIVI 10:** Të përmirësohet përkrahja ndaj fëmijëve dhe të rinjve të cilët janë lënë anash nga aspekti i edukimit dhe arsimit.

**Masat sipas objektivit 10:**

1. Analiza e gjendjes ekzistuese .
2. Përpilimi dhe implementimi i i programit për fëmijët dhe të rinjtë të përjashtuar nga aspekti social.
3. Monitorimi dhe valorizimi i programit të fëmijëve dhe të rinjve të përjashtuar nga aspekti social.
4. Analiza e gjendjes ekzistuese me fëmijët dhe të rinjtë moshë e të cilëve nuk përkon me format e sistemit ekzistues arsimor.
5. Vendosja e bashkëpunimit ndër institucional.
6. Përpilimi dhe implementimi i programit për fëmijët “fantom”.

7. Monitorimi dhe valorizimi i programit për fëmijët “fantom”.

**OBJEKTIVI 11:** Përfshirje përkatëse në procesin e arsimit të fëmijëve me nevoja dhe interes të veçantë ( fëmijë të talentuar dhe me inteligjencë mbi mesataren, fëmijë hiperaktiv, fëmijë me disleksion etj).

**Masa sipas objektit 11:**

1. Shënimi i kartës së nevojave .
2. Analiza dhe përkufizimi i qasjes dhe bashkëpunimi i institucioneve dhe OC.
3. Analiza e programeve ekzistuese mësimore për fëmijë me nevoja dhe interesa të veçanta dhe sipas nevojës adaptimi dhe përgatitja e programeve të reja.
4. Implementimi dhe monitorimi i ndryshimeve.
5. Aftësimi i kuadrit ekzistues.
6. Angazhimi i kuadrit plotësues.
7. Stërvitja e shërbimit profesional.

**OBJEKTIVI 12:** të përmirësohet oferta e arsimit jo formal për grupe speciale të fëmijëve dhe të rinjve.

**Masat sipas objektivit 12:**

1. Vënia e bashkëpunimit të OC dhe institucioneve .
2. Analiza e nevojave.
3. Përgatitja e programeve dhe implementimi i tyre.
4. Hapja e qendrave edukative.
5. Angazhimi i kuadrit përkatës.





**OBJEKTIVI 13:** Të zhvillohet sistemi për mbrojtjen e të dhënave personale të fëmijëve dhe të të rinjve në sistemin arsimor.

#### Masa sipas objektivit 13:

1. Analiza e programeve ekzistuese sipas lëndëve: punë me kompjuterë, informatika dhe projekte nga informatika, me qëllim aplikimi të rekomandimeve nga aspekti i mbrojtjes së të dhënave personale.
2. Analiza e programeve ekzistuese sipas lëndës shkathtësitë jetësore, me qëllim të aplikimit të rekomandimeve nga aspekti i mbrojtjes së të dhënave personale.
3. Fushatë për informim të gjerë në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale.

Bartës të masave nga fusha e Arsimit janë: Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Byroja për Zhvillimin e Arsimit, Inspektorati Shtetëror i Arsimit, Qendra Shtetërore e Provimeve, Qendra për Arsimim Profesional dhe Trajnim, Qendra për Arsimim të të Rriturve, entet publike dhe private të arsimit të lartë, shkollat fillore dhe të mesme, njësitë e pushtetit lokal, Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale dhe Drejtoria për Mbrojtjen e të dhënave personale.

#### Fusha tematike: PUNËSIMI DHE PËRKRAHJA PARA PUNËSIMIT

(Vetë)punësimi paraqet etapën e rëndësishme në pavarësimin e çdo të riu, hapin e rëndësishëm në procesin e vetë realizimit dhe transformimit të tij në faktor të barabartë dhe aktiv në një shoqëri. Punësimi më shpesh paraqet edhe hapin e parë në arritjen e pavarësisë financiare dhe sociale dhe si i tillë është një nga përcaktuesit kryesorë për kalimin në botën e të rriturve, lidhur, ngushtë me cilësinë e jetës së të rinjve, vetëbesimin e tyre, mundësitë për mobilizim, por edhe për vendime praktike lidhur me shtëpinë, ngritjen e familjes dhe çeljen e rrugës së zhvillimit të ardhshëm profesional dhe të karrierës.

Duke marrë parasysh ndikimet që kjo çështje i ka ndaj cilësisë së përgjithshme të jetës së të rinjve, (pa) punësia e rinisë pa dyshim mbetet njëri nga prioritetet kyçe dhe përcaktues i shkallës së zhvillimit të një shoqërie. Në të njëjtën kohë tejkalimi i gjendjes me papunësi të madhe të të rinjve kërkon qasje sistematike, komplementare dhe të koordinuar në fusha të ndryshme dhe të politikave (arsim, punë dhe politikë sociale) për shkak të kompleksitetit të faktorëve që ndikojnë në paraqitjen e saj.

Aspektet kryesore të (pa)punësisë rinore janë koha për kalim nga arsimimi në punë, shfrytëzimi përkatësisht mos shfrytëzimi i të rinjve si forcë pune, jo vetëm në kuptimin e përfshirjes së tyre në popullatën aktive por edhe vënien e tyre në vende të punës të cilat janë në pajtim me kualifikimin e tyre (për shfrytëzimin e plotë të potencialit të tyre), si dhe karakteristikat e vendeve nëpunës në të cilat janë të punësuar të rinjtë (me kohë pune të caktuar/pacaktuar, vetëpunësim, të plotë ose parcial etj).

Si sfida kryesore që ndikojnë në nivelin e papunësisë tek të rinjtë veçohen gjendja e përgjithshme ekonomike me mungesën e ofertës adekuate të vendeve nëpunës nga ana e punëdhënësve, ndërsa të rinjtë nuk kanë kompetenca që kërkohen nga tregu, ndërsa një pjesë e të rinjve konsiderojnë



se është e nevojshme të gjenden intervenime afatgjata dhe sistemore të cilat do të ndihmojnë në tejkalimin e papunësisë së të rinjve. Është e nevojshme që të bëhen përpjekje për ndryshimin e mospërfilljes dhe të mos motivimit tek të rinjtë në procesin e (vetë)punësimit si dhe të shtohet mbështetja për sipërmarrjen rinore.

Në pajtim me sfidat e përcaktuara kryesore në lëmin e punësimit dhe përkrahjes para punësimit, parashihen objektiva përkatëse afatgjata dhe masa specifike nëpërmjet të cilave do të veprohet për zgjidhjen e problemeve të përmendura.

**OBJEKTIVI 1:** Krijimi i mundësive të qasjes për të gjithë të rinjtë për të pasur kompetenca (dituri, qëndrime dhe shkathtësi) të cilat kërkohen në tregun e punës.

#### Masat sipas objektivit 1:

1. Harmonizimi strategjik i ofertës arsimore me nevojat e biznes-sektorit – profile dhe kompetenca të cilat kërkohen në tregun e punës në nivelin lokal dhe nacional.
2. Analizë e vazhdueshme e aspektit të punësimit të të diplomuarve me qëllim të përparimit të efekteve të arsimimit.
3. Stimulimi i bursave, (të paguara dhe pa pagesë) të praktikës dhe të punësimit nga ana e komunitetit të biznesit (Përfshirë edhe NVM) në bashkëpunim të drejtpërdrejtë me entet arsimore.
4. Promovimi i kompetencave kyçe si pjesë integrale të arsimit fillor dhe të stërvitjes.
5. Ngritja e vetëdijes për nevojën e të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe nxitja e përgjegjësisë personale për përfshirje në arsimim dhe aftësim të vazhdueshëm.
6. Përkrahje e dhënësve të arsimimit jo formal për ofertë minimale qasjeje për aftësim në shkathhtësitë “e lehta” në çdo komunë.

7. Promovimi i praktikave për rikualifikim dhe kualifikim plotësues të kuadrove si pjesë e ofertës të institucioneve të arsimit të lartë.
8. Oferta e arsimimi si vokacion në pajtim me tregun lokal të punës në kuadër të çdo komune.
9. Identifikimi i kompetencave të fituara nëpërmjet sistemit arsimor joformal .
10. Nxitja e kulturës të punës praktike tek të rinjtë gjatë ose menjëherë pas kompletimit të arsimimit.
11. Stimulimi i komunitetit të biznesit për shfrytëzim më të mirë të përfitimeve nga puna praktike.
12. Nxitja e praktikave të kohës fleksible punuese (kohë e pjesshme punuese, kompensime sipas orëve, punë prej në shtëpi...)

**OBJEKTIVI 2:** Promovimi i qasjes afatgjate dhe ndërresorëve në politikat për ndihmë për punësim të të rinjve.

#### Masa sipas objektivit 2:

1. Promovimi i politikave lokale dhe nacionale të cilat synojnë çështjet e papunësisë së të rinjve.
2. Politikat “sipas masës” për kategori të ndryshme të të rinjve pa punë (grupet e prekura, NEET, të papunët strukturor, të vetëpunësuar, shfrytëzues të ndihmës financiare).
3. Sistem i kapshëm dhe efektiv i orientimit profesional.
4. Përkrahje e institucioneve arsimore të larta të përgjithshme në hapjen e qendrave për karrierë dhe përkrahje të sipërmarrësve të kapshme për çdo të ri.
5. Implementimi i politikës specifike shumë sektoriale për uljen agresive të papunësisë së të rinjve (p.sh. Youth Guarantee).



**OBJEKTIVI 3:** të rinjtë si partnerë aktivë dhe kreativë në procesin e uljes së papunësisë.

#### Masat sipas objektivit 3:

1. Mbështetja e iniciativave të cilat do të bëjnë ngritjen dhe promovimin e pamjes së të rinjve si përgjegjës, të aftë dhe liderë inovacionesh në vende të ndryshme në botën profesionale.
2. Zhvillimi i punës rinore si pjesë e sistemit të përkrahjes së punësimit.
3. Promovim i punësimit dhe shpërblimit sipas meritës në kuadër të administratës.
4. Rritja e transparencës gjatë punësimit.
5. Promovimi i rezultateve të forcës punuese cilësore dhe avancimi sipas meritës tek komuniteti i biznesit.
6. ngritja e vetëdijes të komunitetit të biznesit për rëndësinë e investimit në burime njerëzore.
7. Promovimi i aktivitetit dhe kompatibilitetit konstruktiv si vlera në arsimit dhe stërvitje.
8. Ngritja e përgjegjësisë personale për të ardhmen personale.

**OBJEKTIVI 4:** Sigurimi i përkrahjes sistemore dhe koordinuese për zhvillimin e sipërmarrjes rinore.

#### Masa sipas objektivit 4:

1. Promovimi i të rinjve si sipërmarrës të suksesshëm.
2. Promovimi i punës sipërmarrëse si model valid dhe i dëshirueshëm i zhvillimit profesional.
3. Aplikimi i arsimimit financiar si pjesë e arsimit dhe aftësimimit themelor.
4. Integrimi i arsimimit sipërmarrës dhe vlerave në arsimin fillor, të mesëm dhe të lartë.

5. Stimulimi i zhvillimit të programeve të kapshme dhe cilësore për sipërmarrje në kuadër të ofertesë të arsimit joformal në tërë territorin e vendit.
6. Politika dhe lehtësime specifike për të rinjtë të vetëpunësuar dhe për biznese drejtuar nga të rinjtë ( ulje tatimesh, më pak obligime administrative...).
7. Sigurimi i përkrahjes sistemore (stërvitje, këshillime, trajnime) për të gjitha bizneset e drejtuara nga të rinjtë gjatë 3 viteve të para.
8. Stimulimi për hapjen e biznes-inkubatorëve dhe qendrave për përkrahje të bizneseve të reja dhe NVM të drejtuara nga t rinjtë.
9. Linja të volitshme financiare për kreditimin e sipërmarrësve të rinj.
10. Përkrahje e sipërmarrësve të rinj për internacionalizimin dhe globalizimin e bizneseve të tyre.

Bartës të masave të parapara në këtë fushë janë Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Agjencia e të Rinjve dhe Sportit, Agjencia Nacionale e Programeve Arsimore Evropiane dhe Mobilizimit, Ministria e Pushtetit Lokal dhe Partnerët Social.



## **Fusha tematike:** **KULTURA**

Kultura është faktor që e nxitë zhvillimin civilizues, e rritë kohezionin shoqëror dhe e profilizon pamjen e një shteti në suaza ndërkombëtare (definicioni i strategjisë nacionale për zhvillimin e kulturës). Ajo përfshin një grumbull masash dhe aktivitete për përmirësimin e jetës kulturore-rekreative dhe ofertën kulturore për të rinjtë në Maqedoni, e cila përfshinë muzikën, teatrin, filmin, letërsinë, botimet, pikturën, skulpturën, kërcimin bashkëkohor etj. Në fushën e kulturës ka pak të dhëna të kapshme që kanë të bëjnë me të rinjtë në nivel nacional. Në përgjithësi, strategjitë dhe politikat të cilat i zbaton Ministria e Kulturës kanë të bëjnë me kulturën si fushë, por jo edhe me lidhshmërinë specifike të kulturës me të rinjtë.

Sfidat kryesore të definuar në këtë fushë janë: mungesa e ngjarjeve të rregullta kulturore për të rinjtë (koncerte, ngjarje multimediale) në vise jashtë Shkupit, mosinteresim tek të rinjtë të ndjekin ngjarjet kulturore dhe institucionet kulturore, por edhe kulturën e re mediatike e cila imponohet tek të rinjtë në llogari të letërsisë, për të cilën nuk ka aftësi të mjaftueshme mediatike. Të rinjtë shumë rrallë kanë interesim për krijimtarinë artistike kreative në formë të organizuar dhe ata për fat të keq nuk e dinë ndikimin e kulturës mediatike si dhe manipulimet të cilat krijojnë kontekst negativ për kulturën e huaj.

Këto sfida kyçe më tutje shkaktojnë rritjen e hendekut në të kuptuarit dhe njohuritë për zhvillim kulturor ndër të rinjtë në Shkup dhe të rinjve që jetojnë jashtë Shkupit, zvogëlimin e potencialit kreativ tek të rinjtë, veçanërisht tek ata që jetojnë jashtë Shkupit, zvogëlimin e numrit të të rinjve të cilët marrin informacione nga mediet. Gjithashtu përmbajtjet jo adekuate të medimeve për kulturën mund të ndikojnë negativisht tek të rinjtë gjatë përkufizimit të identitetit kulturor dhe mirëkuptimit të kulturave tjera.

Në pajtim me sfidat kryesore të përcaktuara në fushën e kulturës, parashihen objektiva përkatëse afatgjate dhe masa specifike nëpërmjet të cilave do të bëhet ndikim në zgjidhjen e tyre.

**OBJEKTIVI 1:** Sistem përparimtar dhe i qëndrueshëm i praktikave kreative dhe kulturore të të rinjve.

### **Masat sipas objektivit 1:**

1. Hulumtimi/shënimi i kartës së programeve ekzistuese në shkollat e mesme me qëllim përmirësimi të tyre dhe përfshirje në to të përmbajtjeve kulturore.
2. Aplikimi i mekanizmave konkrete për kontrollin e përfaqësimit dhe llojeve të përmbajtjeve kulturore në programe.
3. Futja e instrumenteve për ndjekjen e rrjedhave arsimor në Evropë.
4. Analiza e cilësisë dhe sasisë së praktikës ekzistuese lidhur me krijimtarinë kulturore dhe kreative të studentëve.
5. Përpilimi i programeve efektive të cilat do të ofrojnë qasje dhe rol aktiv për të rinjtë dhe studentët në krijimtarinë kreative të të rinjve.
6. Përforcimi i kapaciteteve të institucioneve për të mundësuar praktikën adekuate për studentët.
7. Programe të reja efektive të inovacioneve për zhvillimin e kapaciteteve tek të rinjtë për krijimtarinë kreative (stërvitje dhe kurse) dhe përforcimi i kapaciteteve ekzistuese.
8. Formimi i një fondi të ri nga ana e Ministrisë së Kulturës për projekte për inovacione dhe në industri të krijuara dhe zbatuara nga të rinjtë.



**OBJEKTIVI 2:** Përmirësimi i cilësisë së jetës kulturo-argëtuese të të rinjve.

### Masat sipas objektivit 2:

1. Analiza e programeve ekzistuese të aktiviteteve kulturore në nivel nacional dhe lokal.
2. Përpilimi i planeve lokale të veprimit në kulturën e të rinjve.
3. Nxitja e bashkëpunimit me asociacione amatore kulturore.
4. Nxitja e institucioneve kulturore për të mundësuar kushte për aktivitete muzikore, dramatike, figurative të të rinjve.
5. Decentralizimi i ngjarjeve kulturore (festivaleve, koncerteve etj.).
6. Shënimi i kartës së vendeve kulturore funksionale
7. Takime të rregullta strukturore ndërmjet faktorëve kulturor për nxitjen e bashkëpunimit.
8. Ndërlidhja e institucioneve funksionale kulturore dhe lidhja e tyre me pushtetin lokal me faktorët relevant (OJQ, shoqata kulturore, artistë).
9. Futja në rrjetet ndërkombëtare të institucioneve kulturore.
10. Hapja e vendeve të reja kulturore në komunat ku ato nuk ekzistojnë.
11. Krijimi i listës së objekteve dhe enteve kulturore për të rinjtë.
12. Shfrytëzimi i teknologjive të reja (TI- aplikime që do të japë informacione për ofertën kulturore në nivel lokal).
13. Analiza e cilësisë dhe sasisë së përmbajtjeve ekzistuese mediatike nga lëmi i kulturës.

14. Aplikimi i kuotës për emetim të detyrueshëm të programeve kulturore-argëtuese për të rinjtë.

15. Futja e përmbajtjeve programore në servis publik të iniciuar nga të rinjtë.

16. Bashkëpunimi ndërmjet Agjencisë për Shërbime Audio dhe Audio-Vizuale dhe asociacioneve kulturore në monitorimin dhe analizën e ofertës mediatike nga lëmi i kulturës për të rinjtë.

17. Mbështetje për vënien e kanalit mediatik të të rinjve në kuadër të servisit publik.

**OBJEKTIVI 3:** Qasje e barabartë e të rinjve në ofertën kulturore cilësore dhe mundësitë për bashkëpunim kulturor.

### Masa sipas objektivit 3:

1. Analiza e ofertës kulturore në territorin e RM e cila është e kapshme për të rinjtë me qëllim të shpërndarjes së barabartë të ofertës kulturore.
2. Përpilimi i programit nacional të aktiviteteve të ndryshme kulturore të shpërndara nëpër territorin e RM me qëllim të kapjes dhe plotësimit të nevojave të problemeve të të rinjve.
3. Bashkëpunimi ndër institucional në nivel lokal dhe gjetja e mënyrave të bashkëpunimit me sektorin e biznesit.
4. Instalimi i sistemit të rregullt të informimit, afimit dhe njohjes së programeve/potencialëve të BE (nëpërmjet ngjarjeve, fushatave, punëtorive, stërvitjeve) për iniciativa rinore dhe riprodhimi i tyre nëpërmjet programeve evropiane.
5. Përforsimi i kapaciteteve të faktorëve kulturor për përgatitjen e projekteve në kuadër të programeve të BE për kulturë.
6. Mbështetja e proceseve për vënien e partneritetit në shtet dhe jashtë tij, me vizita studentore.



**OBJEKTIVI 4:** Të rinjtë janë përfshirë në krijimin dhe zbatimin e politikave kulturore.

**Masat sipas objektivit 4:**

1. Identifikimi i potencialeve për përfshirjen e të rinjve në proceset e krijimit të politikave për të rinjtë.
2. Informimi i të rinjve për mundësitë për pjesëmarrje në krijimin dhe zbatimin e politikave kulturore.
3. Nxitja e bashkëpunimit ndërmjet komunave.
4. Promovimi i vlerave tradicionale kulturore (artizanati, etnokultura) me qëllim ruajtjes së tyre.
5. Zgjerimi i vëllimit të punës dhe financave të këshillave lokale të të rinjve me qëllim të përfshirjes në aktivitetet kulturore

Bartës të masave në fushën e Kulturës janë: Ministria e Kulturës, Ministria e Punës dhe e Politikës Sociale, institucionet arsimore, institucionet kulturore në nivel lokal, njësitë e pushtetit lokal, mediet, Radio-televizioni i Maqedonisë, Agjencia e Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audio-vizuale, Ministria e Shoqërisë Informative dhe Administratës Publike dhe biznes sektori.

**Fusha tematike:**  
**SPORTI**

Sporti paraqet çdo formë të aktivitetit fizik nëpërmjet pjesëmarrjes së përkohshme dhe/ose të organizuar dhe të objektivave rreth të shprehurit ose përmirësimit të gatishmërisë fizike dhe mirëqenies mendore, krijon lidhje sociale ose arrin rezultate në gara të të gjitha niveleve. Sporti kontribuon në zhvillimin profesional dhe social nëpërmjet aktiviteteve kreative, angazhimeve rekreative dhe ngritjes së shprehive të shëndetshme jetësore tek individët, veçanërisht ky aktivitet ndihmon për mirëqenie fizike dhe mendore tek të rinjtë. Sporti është pjesë edhe e Kushtetutës së RM ku në nenin 47, alineja 5 thuhet: “Republika i nxit dhe i ndihmon teknikën, kulturën dhe sportin”, dhe sipas kësaj sporti duhet të jetë segment i pandryshuar i zhvillimit të çdo gjenerate.

Si sfida kryesore në këtë fushë paraqiten mungesa e përkrahjes më të madhe të shtetit, të vetë administrimit lokal dhe të federatave të cilat në mënyrë të rregullt dhe të tërësishme të ndjekin situatën me zhvillimin e sportit. Nevojitet valorizimi i mjeteve të deponuara sipas rezultateve dhe numrit të të rinjve të përfshirë. Veçanërisht mjetet e pushtetit lokal duhet të shfrytëzohen për sporte masive të të gjithë të rinjve, por shumë rrallë edhe për sporte individuale (ose bursa për individë). Derdhja e mjeteve të kufizuara për sportin të të ashtuquajtur sporte kulmore duhet të kontrollohet, ndërsa ata të marrin mjete më së shumti nëpërmjet shitjes së të drejtave televizive, sponsorëve, biletave e kështu me radhë.

Parimi dhe programi “Sporti për të gjithë” ekziston, por nuk është tërësisht funksional që t’i mundësojë çdo individ të marrë pjesë në sport dhe me këtë rast të sigurojë se të gjithë të rinjtë kanë mundësi të fitojnë arsimim fizik, orientime dhe mundësi për të arritur shkathtësitë themelore sportive sikurse janë aspekti motorik, shëndeti sportiv etj. Për zhvillimin e sportit tek të rinjtë është i nevojshëm bashkëpunimi i të gjithë palëve të preokupuara, përfshirë këtu qasjen e decentralizuar dhe bashkëpunimin në nivel lokal, si dhe përfshirjen aktive të sektorit qytetar.



Deri tani nuk ka pasur ndërlidhje të sportit me edukimin e drejtpërdrejtë për mbrojtje dhe shëndet në sport, higjienën në sport, punën ekipore, përgjegjësinë, vlerat etike dhe morale, ndërsa të rinjtë përmenden vetëm në pjesën e “kujdesit dhe mbështetjes së sportit shkollor dhe të fakulteteve”, që është kurthi kryesor për lënie anash të kësaj fushe. Në pajtim me përcaktimin e sfidave kryesore në fushën e sportit, janë paraparë objektivat adekuate afatgjata dhe masa specifike nëpërmjet të cilave do të veprohet në këtë fushë.

**OBJEKTIVI 1:** Krijimi i sistemit të qëndrueshëm për monitorimin e të rinjve për përfshirjen e tyre të rregullt dhe për sport aktiv.

#### Masa sipas objektivit 1:

1. Hulumtimi i kushteve ekzistuese në të cilat të rinjtë mund të praktikojnë sport dhe qasje tek objektet.
2. Përpilimi i programeve të pavarura për përfshirjen e të rinjve në aktivitetet sportive me fokus të veçantë në tri kategori 13 deri 18, 19 deri 23 dhe 24 deri 29 vjet.

**OBJEKTIVI 2:** Qasje e barabartë e të gjithë të rinjve tek objektet dhe aktivitetet sportive të cilat ofrohen për shëndet mental dhe fizik.

#### Masat sipas objektivit 2:

1. Analizë e qasjes në të gjitha kapacitetet sportive.
2. Vendime për terminë të rregullt.
3. Përpilimi i planit të monitorimit për përqindjen e përfshirjes tek turinjtë.
4. Shënimi i kartës së lokacioneve sipas nevojave.
5. Takime qytetarësh, bashkëpunim dhe nxitje për “konsumimin” e sportit.

6. Krijimi i potencialeve për kapacitete të reja për “konsumimin” e sportit.
7. Krijimi i kartelave të anëtarësimit për nxënës, studentë, të rinj të papunë, prindër të rinj.

**OBJEKTIVI 3:** Bashkëpunim i gjithanshëm i të gjitha institucioneve në shtet që kontribuojnë në sport dhe promovim i “Sporti për të gjithë”.

#### Masa sipas objektivit 3:

1. Bashkëpunimi ndër institucional në të gjitha nivelet, veçanërisht në nivelin lokal.
2. Përpilimi i programit për zhvillim dhe observim.
3. Dërgimin e rekomandimeve te Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe te institucionet relevante.

**OBJEKTIVI 4:** Përqindje e lartë e të rinjve janë përfshirë në krijimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të sportit.

#### Masa sipas objektivit 4:

1. Zhvillimi i programit për përfshirjen e të rinjve të cilët nuk merren me sporte kulmore.
2. Programi për nxitjen e bashkëpunimit aktiv të shkollave me klubet lokale sportive, shoqatat qytetare dhe me federatat nacionale sportive.
3. Promovimi i rëndësisë së sportit.
4. Trup jo formal/ trupa jo formale nëpër Maqedoni për edukimin dhe promovimin për përfshirje aktive në sport dhe në politikën sportive.
5. Praktikë e pjesëmarrjes aktive të të rinjve nëpërmjet programeve adekuate.
6. Krijimi i mundësive për trupa të pavarura sportive të të rinjve të cilat do të merren me sport



dhe krijimin e politikave të pavarura sportive, në korrelacion me obligimet ligjore.

7. Edukimi dhe mbështetja e programeve të të rinjve me pengesa në zhvillim.

**OBJEKTIVI 5:** Aktivitete vjetore kreative të cilat u dedikohen të rinjve të moshave prej 15 deri 22 vjet për pjesëmarrje të rregullt në sport.

#### Masa sipas objektivit 5:

1. Përkushtim për çdo muaj –sportit të veçantë
2. Krijimi i sistemit të shpërblimeve dhe motivimin e të rinjve më aktiv.
3. Analiza e potencialit për evidencën për peshën e tepërt dhe për majmen (bulimia) tek të rinjtë.
4. Formimi i klubeve të prindërve dhe fëmijëve.
5. Liga sportive.
6. Bashkëpunimi me Ministrinë e Arsimit dhe ARS me fakultetin për sport për krijimin e programit të ri bashkëkohor me qasje kreative të të rinjtë.
7. Përcaktimi i potencialeve për ndërhyrje në arsimin e lartë.
8. Përpilimi i propozim-programit për zhvillimin e sportit tek të rinjve të cilët e vazhdojnë arsimimin.
9. Krijimi i kushteve për strategji të të rinjve që nuk e vazhdojnë arsimimin.

Bartës të masave të parapara me këtë fushë janë: Agjencia e të rinjve dhe sportit, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Ministria e Shëndetësisë, Qeveria e Republikës së Maqedonisë, njësitë e pushtetit lokal, federatat sportive, Fakulteti i arsimimit fizik, sport dhe shëndet, institucionet arsimore, organizatat civile, sektori i biznesit.

#### Fusha tematike: SHËNDETI

Shëndeti është gjendje e mirëqenies së plotë fizike, psikike dhe sociale, dhe jo vetëm mungesë e sëmundjes ose defekteve trupore. Prandaj kjo temë në kuadër të strategjisë përfshinë shumë komponentë të rëndësishëm synimi i të cilave është jo vetëm që të ruaj dhe përparojë shëndetin e të rinjve, por edhe të kontribuojë në mirëqenien e përgjithshme të popullsisë. Objektivi është që nëpërmjet politikave të integruara shëndetësore, të fokusuara në programe preventive, të kombinuara me qasje për ndarjen e informacioneve dhe promovimin e stileve jetësore të shëndetshme të mbrohet shëndeti i të rinjve. Në këtë mënyrë, nëpërmjet investimit në parandalim, drejtpërdrejtë ndikohet në zvogëlimin e dukurive të sëmundjeve kronike dhe infektive dhe përmirësohet cilësia e jetës.

Sfidat kryesore në fushën e shëndetit lidhen me trendin në rritje të sjelljeve të rrezikshme të të rinjve në Maqedoni të lidhura me shëndetin seksual dhe riprodhues, tendenca e shtuar e përdorimit të alkoolit, duhanit dhe substancave psikike-aktive, rritjes së dukurisë të rasteve të dhunës (bazuar në moshë dhe në gjini), dhunimit, lëndimeve ndërmjet të rinjve, të rinjve të lënë në rrugë, rritjes së pasojave për shkak të ushqimit të parregullt, peshës së tepërt, anoreksisë dhe bulimisë si dhe rritjes së rasteve të shumta të lëndimeve dhe vdekjeve tek të rinjtë si pasojë e fatkeqësive në komunikacion. Këtyre sfidave u bashkëngjitet edhe mungesa e qendrave për përkrahje, trajtim, rehabilitim dhe risocializim për personat që jetojnë me hepatitin HIV, personave që përdorin substanca psikike-aktive dhe varshmërive të tjera, qasja jo e mjaftueshme e shërbimeve cilësore shëndetësore për grupet e prekura të të rinjve, informimi i dobët i të rinjve për programet dhe aktivitetet e implementimit nga ana e institucioneve dhe organizatave të ndryshme, mungesa e aktiviteteve për identifikimin dhe trajtimin të çrregullimeve mendore të të rinjve, këshillime për njohje të vetvetes, dhe ndërhyrje dhe angazhim i dobët rreth grupeve të prekura të fokusuara dhe skenimi i shëndetit të tyre të përgjithshëm dhe përkrahja e nevojshme.





Në pajtim me sfidat e përcaktuara kryesore në fushën e shëndetit, parashihen objektiva përkatëse afatgjatë dhe masa specifike nëpërmjet të cilave do të vepronet.

**OBJEKTIVI 1:** Të zvogëlohet sjellja e rrezikshme ( lidhur me SHSR, konsumimin e duhanit, alkoolit dhe SPA) dhe dhuna tek të rinjtë në Maqedoni në moshën prej 15 deri 25 vjet deri në vitin 2025.

#### Masat sipas objektivit 1:

1. Rritja e qasjes në programet e parandalimit të sëmundjeve të varshmërisë tek të rinjtë.
2. Rritja e qasjes në programe specifike për përparimin e SHSR tek të rinjtë.
3. Edukim i gjithanshëm seksual në arsim
4. Ulja e çmimeve të mjeteve kontraceptive .
5. Përforsimi i kapaciteteve të shërbimeve të Ndihmës së parë për identifikimin dhe trajtimin e dozimit të tepërt me substanca psikike-aktive.
6. Formimi i qendrës informative në kuadër të ARS që do të ketë për detyrë të zhvillojë programe/aktivitete dhe qasje për informim më tumirë të të rinjve me listë të shpallur të institucioneve dhe shërbimeve përgjegjëse që i ofrojnë.
7. Krijimi i aplikacionit-mobil këshilltar për shërbime shëndetësore.
8. Promovimi i paket shërbimeve pa pagesë për vajza të reja dhe gra.

**OBJEKTIVI 2:** Të përmirësohen kushtet e dedukcionit të shëndetit mendor dhe sjelljes tek të rinjtë në Maqedoni.

#### Masa sipas objektivit 2:

1. Përpilimi i programeve për përparimin e shëndetit mental.
2. Rigjallërimi i qendrave të shëndetit mendor.
3. Bashkëpunimi i përforsuar i shërbimeve profesionale në shkolla për identifikimin e sjelljes së dhunshme dhe viktimave të dhunës (me bazë gjinore dhe lloje të tjera të dhunës).
4. Promovimi dhe rritja e kapaciteteve në qendrat e punës sociale.
5. Edukime të moshatarëve.
6. Sensibilizimi i profesionistëve për sjellje me përfaqësuesit e të rinjve.

**OBJEKTIVI 3:** Të fitohen shprehë të shëndosha ushqyese tek të rinjtë e moshës prej 15 deri 19 vjet.

#### Masa sipas objektivit 3:

1. Kontrollime sistematike të rregullta të cilat do të përfshijnë ndjekjen e zhvillimit të fëmijëve.
2. Të bëhet program personal për çdo fëmijë në shkollën e mesme.
3. Promovimi i stileve të shëndetshme të jetesës.
4. Aplikimi i edukimit mjekësor të vazhdueshëm për tema të kësaj fushe.
5. Përfshirja e punëtorëve shëndetësor në trajnime për parandalim të shtimit të peshës trupore, anoreksisë dhe bulimisë.



**OBJEKTIVI 4:** Të rritet vetëdija tek të rinjtë për përgjegjësitë gjatë pjesëmarrjes në komunikacion rrugor.

**Masa sipas objektivit 4:**

1. Ngritja e vetëdijes dhe kulturës në komunikacion tek të rinjtë.
2. Futja e orëve plotësues për siguri në komunikacion.
3. Aplikimi i sistemit të këshillave psikologjike në dhe jashtë suazave të sistemit arsimor për shmangien e agresivitetit tek turinjtë.
4. Aplikimi i infrastrukturës adekuate për përfshirje të sigurt të të gjithë pjesëmarrësve në komunikacion (rrugicat e biçikletave, vendkalimeve të këmbësorëve, sinjalizimeve adekuate etj.).

**OBJEKTIVI 5:** Të mundësohet qasje e barabartë në mbrojtjen shëndetësore për të gjithë të rinjtë.

**Masa sipas objektivit 5:**

1. Hapja e pikave për marrjen e dokumenteve përkatës me të cilat mundësohet mbrojtje shëndetësore afër vendit të banimit.
2. Shtimi i kapaciteteve të kuadrit shëndetësor për punë me grupet e prekura të të rinjve.
3. Përsosja dhe përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese për qasje më të mirë tek institucionet për të rinj me nevoja të veçanta.
4. Promovimi i testimit vullnetar për Hepatitin C dhe HIV.
5. Përpilimi i programit të standardizuar të shëndetësisë dhe përmirësimit të stileve të shëndosha jetësore, që në vete përfshinë edhe edukimin e gjithanshëm seksual.

**OBJEKTIVI 6:** të krijohen kushte për rehabilitim të papenguar dhe risocializim të kategorive të prekura të të rinjve.

**Masa sipas objektivit 6:**

1. Formimi i qendrave për rehabilitim dhe risocializim.
2. Angazhimi dhe puna me persona të cilët përdorin drogën.
3. zhvillimi i këshillimoreve për shëndet familjar dhe përmirësimi i kushteve për mbështetje psikologjike në dhe jashtë enteve shëndetësore.
4. Miratimi i protokollit të trajtimit të personave të mitur të cilët përdorin SPA.
5. Kapaciteti i përforcuar i qendrave për mjekim të sëmundjeve të varshmërisë për punë me të miturit.

Bartës të masave të parapara me këtë fushë janë :Agjencia e të Rinjve dhe Sportit, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Punës dhe Politikës sociale, Ministria e Shëndetësisë, Instituti i Shëndetit Publik, Byroja për Zhvillimin e Arsimit, Ministria e Punëve të Brendshme, Agjencia e Barnave dhe Mjeteve Mjekësore, Qendrat e Punës Sociale, Këshilli Republikan i Sigurisë në Komunikacionin Rrugor, njësitë e pushtetit lokal, Fakulteti i Mjekësisë, organizatat qytetare, sektori i biznesit.



## **Fusha tematike:** **CILËSIA E JETËS**

Me cilësinë e jetës nënkuptohet mirëqenia e përgjithshme e individëve dhe shoqërisë. Cilësia e jetës në vete përfshin spektrin e gjerë të fushave, ndër të cilat janë zhvillimi ndërkombëtar, shëndeti, politika dhe punësimi. Indikatorët standard për cilësinë e jetës nuk e përfshijnë vetëm elementin ekonomik (punësimin dhe të ardhurat) por edhe mjedisin jetësor, shëndetin fizik dhe mendor, arsimin, rekreacionin, kohën e lirë dhe përfaqësimin në qarqet sociale. Segment plotësues që ndikojnë në cilësinë e jetës janë edhe liria, të drejtat e njeriut dhe lumturia. Cilësia e jetës nuk duhet të identifikohet me konceptin e standardit të jetës i cili fokusin më të madh ia kushton stabilitetit ekonomik dhe të ardhurave.

Fusha tematike cilësia e jetës në vete përmban elemente nga të gjitha fushat tematike të përpunuara deri tani, por njëkohësisht fokusohet edhe tek të rejtat të cilat nuk i takojnë drejtpërdrejtë fushave ekzistuese.

Problemet më të mëdha me të cilat ballafaqohen të rinjtë në Republikën e Maqedonisë, nga të cilat drejtpërdrejtë varet cilësia e jetës së të rinjve janë mundësitë e vogla për pavarësim të të rinjve, nëpërmjet punësimit, standardit të ulët rinor, zhvillimi jo adekuat rural i cili në mënyrë plotësuese e vështirëson gjendjen e të rinjve në mjediset rurale, cilësia e keqësuar e ajrit dhe prishja e mjedisit jetësor të cilat drejtpërdrejtë ndikojnë në cilësinë e jetës jo vetëm tek të rinjtë, por tek popullsia e tërë.

Problemet me papunësinë e madhe tek të rinjtë janë përfshirë në pjesën kushtuar fushave të arsimit dhe punësimit, prandaj nuk do të përpunohen në mënyrë të hollësishme në këtë segment, por duhet të theksuar se mbetet një nga problemet esenciale për zbatimin e prioriteteve të përmendura në këto dy fusha, me qëllim që të bëhet përmirësimi i rëndësishëm i cilësisë së jetës së të rinjve gjatë 10 viteve të ardhshme.

Standardi i ulët rinor në vete përmbledh një varg problemesh ndër të cilët rëndësi të veçantë kanë standardet e nxënësve të shkollave të mesme dhe të studentëve, të cilët ofrohen në konviktet e shkollave të mesme dhe të studentëve. Është i nevojshëm renovimi urgjent i të gjitha kapaciteteve të konvikteve të shkollave të mesme dhe studentëve me kapacitete bashkëkohore, në pajtim me nevojat anë e mbanë vendit. Të rinjtë si bartës të së ardhmes së shtetit duhet të kenë mundësi të shkollohen dhe jetojnë në kushte adekuate si qytetarë të barabartë në shtet me perspektive dhe standarde evropiane.

Në kuadër të kësaj përfshihet edhe nevoja për krijimin e shoqatave përfaqësuese të nxënësve të shkollave të mesme dhe studentëve të cilat do t'i përfaqësojnë interesat e tyre dhe do të luftojnë për zhvillim permanent të jetës së nxënësve dhe studentëve nëpërmjet krijimit të kushteve cilësore të jetës dhe mësimi, nëpërmjet ofertës së gjerë kulturore për të rinjtë, nëpërmjet numrit të madh të programeve për mobilizim dhe mësim, pjesëmarrjes së organizuar në gara ndërkombëtare shkencore, konferenca dhe të potencialeve specifike për përparim të të rinjve të shkollave të mesme dhe studentëve.

Fusha cilësia e jetës në vete përfshin edhe mundësitë e njëjta për të gjithë të rinjtë, përkatësisht në këtë kontekst konkret ka të bëjë edhe me të rinjtë që jetojnë në mjediset rurale. Duhet përpjekje plotësuese për sigurimin e kushteve dhe mundësive të barabarta për këta të rinj të cilët në situatën e zhvillimit të pabarabartë lokal shpesh herë gjenden në margjina, të lënë anash për të luftuar me të njëjtat probleme ashtu si të gjithë të rinjtë e tjerë, por me infrastrukturë shumë më të keqe rrugore, qasje më të vështirësuar në teknologjitë e zhvilluara dhe kushte për risi sociale. Të rinjtë në mjediset rurale kanë nevoja specifike të cilat duhet të analizohen në hollësi dhe atyre t'u jepet përgjigje me krijimin e strategjisë specifike për zhvillim të popullatës rinore rurale.



Mbrojtja e mjedisit jetësor edhe pse nuk është ndër ato fusha të përkufizuara më hollësisht me interes për të rinjtë në këtë strategji ajo është me interes të veçantë në cilësinë e jetës dhe me lidhje të ngushtë me shëndetin e të rinjve. Në situatën kur cilësia e ajrit është në nivele brengosëse, gatishmëria për t'u ballafaquar me katastrofa dhe çrregullime elementare në nivele të ulëta, me interes të veçantë për të rinjtë janë edhe këto segmente, të cilat shërbejnë si bazë për sigurimin e kushteve përkatëse për jetë për gjeneratat e ardhshme. Të rinjtë në Republikën e Maqedonisë duhet të kenë mundësi të mësojnë më shumë për

t'u ballafaquar me ndryshimet klimatike dhe të mund të punojnë në ngritjen e kapaciteteve për t'u ballafaquar me kriza dhe fatkeqësitë e tjera elementare.

Fusha cilësi e jetës si fushë me komplekse edhe pse nëpërmjet indikatorëve të thjeshtë nuk mund të masë përparimin e tërësishëm, duhet të përfshijë në vete të gjitha këto angazhime dhe nevoja të të rinjve me qëllim të krijimit të kushteve për zhvillim të mëtejshëm të të rinjve në qytetarë aktiv dhe progresiv të cilët luftojnë për përparimin e zhvillimit të përgjithshëm individual dhe shoqëror.





## AKTORËT KRYESORË DHE ROLET DHE PËRGJEGJËSITË E TYRE

Zbatimi i strategjisë nacionale për të rinjtë patjetër të sigurojë përfshirje të gjerë të të gjithë palëve të interesuara dhe aktorët kryesor të cilët ndikojnë drejtpërdrejtë ose tërthorazi në zhvillimin rinor në shtet. Të gjitha palët e interesuara duhet të marrin përgjegjësi për të kontribuar zbatimin e strategjisë duke pasur parasysh kapacitetet në disponim të limituara të institucioneve. Procesi i tërësishëm duhet të sigurojë lidhshmëri horizontale dhe vertikale të institucioneve lokale dhe nacionale, të sektorit privat dhe të rinjve si shfrytëzues final të kësaj strategjie. Rolet dhe përgjegjësitë e çdo pale të interesuar janë theksuar qartë në këtë strategji.

### Qeveria e Republikës së Maqedonisë

Qeveria si institucion me rol ekzekutiv në zhvillimin e Republikës së Maqedonisë ka rrolin primar në sigurimin e potencialeve për zbatimin e Strategjisë nacionale për të rinj (SNR), nëpërmjet miratimit dhe implementimit të programeve kohezive dhe të koordinuara lidhur me masat e parapara me SNR. Qeveria do të planifikojë dhe zbatojë reforma që i preokupojnë të rinjtë me koordinim adekuat me SNR. Agjencia e të Rinjve dhe Sportit si trup i Qeverisë, përgjegjës për implementim dhe koordinim të politikave rinore në nivel nacional do të ketë rolin për të bërë rregullisht monitorimin dhe njoftimin rreth zbatimit të SNR. Gjatë zbatimit të SNR, ARS dhe Qeveria do të udhëhiqen sipas parimit dhe vlerave të SNR dhe do të veprojnë në mënyrë transparente dhe me llogaridhënie me qëllim njoftimi me kohë dhe planifikimi të programeve dhe projekteve.

### Pushteti lokal

Institucionet lokale do të koordinohen tërësisht me Agjencinë e të Rinjve dhe Sportit gjatë planifikimit dhe zbatimit të programeve lokale për zhvillimin rinor, por në pajtim me objektivat dhe masat e parapara me SNR. Autoritetet lokale do të mbajnë komunikim dhe bashkëpunim produktiv dhe konstruktiv me të rinjtë dhe shoqatat e të rinjve në nivel lokal me qëllim zbatimin përkatës të SNR në procesin inkluziv dhe konsultativ.

### Sektori qytetar

Sektori qytetar i cili zbaton programe dhe projekte për të rinj ka përgjegjësi të madhe për zhvillimin e jetës së përgjithshme të të rinjve. Qasja pozitive ndaj trajtimit të problemeve të të rinjve duhet të jetë në paralele me harmonizimin e planet/programet e objektivave dhe masave të parapara me SNR. Sektori qytetar duhet t'i orientojë kapacitetet e veta në përforcimin e të rinjve që këta të jenë të pavarur dhe të mëvetësishëm, të jenë aktivë dhe të bëhen faktor aktiv në zhvillimin social/politik në Republikën e Maqedonisë. Sektori qytetar duhet t'i promovojë punëtorët rinor si profesionistë të cilët sigurojnë mbështetje të fortë për të rinjtë. Sektori qytetar duhet të bashkëpunojë me autoritetet lokale dhe me komunitetin e biznesit me qëllim zhvillimi i qasjes së gjithanshme drejt adresimit të problemeve më të vështira të të rinjve .

### Komuniteti i biznesit

Komuniteti i biznesit duhet të kontribuojë me ndarje të resurseve të veta me institucionet dhe organizatat qytetare gjatë trajtimit të problemeve të të rinjve në nivelin nacional dhe lokal. Komuniteti i biznesit duhet të jetë faktor aktiv në përforcimin e prosperitetit ekonomik të të rinjve në baza afatgjata.



## Institucionet arsimore

Institucionet arsimore janë një nga aktorët më të prekur në zhvillimin e të rinjve. Kuadri mësimor në institucionet arsimore është në ndërveprim me të rinjtë dhe paraqet faktorin kryesor për zhvillimin e të rinjve si qytetarë akademik të cilët do të kontribuojnë për zhvillimin e tërësishëm të shtetit nga aspekti social, ekonomik dhe politik. Entet arsimore duhet të kenë bashkëpunim adekuat dhe të strukturuar me institucionet, komunitetin e biznesit, sektorin qytetar dhe të rinjtë.

## Mediumet

Mediumet duhet t'i prezantojnë në mënyrë përkatëse të rinjtë dhe nevojat e tyre në opinion, në bashkëpunim të fortë me institucionet dhe sektorin qytetar i cili preokupohet me çështjet e të rinjve. Mediumet duhet të jenë hallkë e cila i lidhë të rinjtë me të moshuarit dhe të ngrenë vetëdijen e të rinjve për veprim për promovimin dhe implementimin e SNR. Mediumet duhet të kujdesen në mënyrë adekuate rreth ndikimit në autoritetin e të rinjve gjatë përmbajtjeve të përditshme.

## Prindër/ të moshuar

Prindërit janë subjekti primar në zhvillimin e të rinjve si qytetarë aktivë. Prindërit duhet të njoftohen për ndryshimet dhe strategjitë për të rinjtë me qëllim që të mësojnë dhe zbatojnë në mënyrë permanente të praktikave pozitive për edukimin dhe arsimimin e të rinjve. Prindërit duhet rregullisht të bashkëpunojnë dhe komunikojnë me entet arsimore me qëllim të këmbimit të informacioneve dhe sigurimit të mbështetjes. Prindërit duhet të synojnë drejt prezantimit të shembujve të mirë për të rinjtë.

## Të rinjtë

Të rinjtë dhe të rejat janë shfrytëzuesit kryesor të Strategjisë nacionale për të rinj. Por, të rinjtë, gjithashtu, duhet të marrin përgjegjësinë për plotësimin e obligimeve që i bart SNR, të jenë të përfshirë aktivisht dhe t shprehin lirshëm mendimin e tyre. Pasi është në interes të tyre, të rinjtë duhet në mënyrë aktive të përfshihen në aktivitetet e monitorimit dhe realizimit të kësaj strategjie.



*Zbatimi i strategjisë nacionale për të rinjtë patjetër të sigurojë përfshirje të gjerë të të gjithë palëve të interesuara dhe aktorët kryesor të cilët ndikojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi në zhvillimin rinor në shtet*



## PLANI I MONITORIMIT

Procesi i ndjekjes së realizimit dhe të suksesit d.m.th. efektet e implementimit të strategjisë do të fokusohet në disa nivele dhe atë:

- ▲ Ndjekja dhe vlerësimi i realizimit të aktiviteteve të parashtruara dhe zgjidhjet filltare për të cilat ato kontribuojnë.
- ▲ Ndjekja dhe vlerësimi i efektit të realizimit të rezultateve grupore në kuadër të fushave tematike.
- ▲ Vlerësim i impaktit të tërësishëm të strategjisë në pajtim me prioritetet strategjike të definuar.

Që të mund të shtrohen dhe të zbatohen në mënyrë adekuate të dhënat e grumbulluara dhe valorizimi i suksesit në pajtim me tre nivelet e përmendura, është e nevojshme që menjëherë pas miratimit të strategjisë të përpunohet veçanërisht Plani për ndjekjen e realizimit dhe suksesit të implementimit të strategjisë. Plani përveç informatave për indikatorët, instrumentet e valorizimit, instrumenteve për grumbullimin e të dhënave dhe të ndarjes së obligimeve për ndjekjen dhe valorizimin e efekteve të implementimit të strategjisë, do të parashohë edhe metoda përkatëse për parashtrimin e bazës fillestare për çdo indikator të përcaktuar, për të cilin do të bëhet vlerësim i rezultateve (të planifikuara kundrejt realizimit) në periudhën e caktuar kohore. Parashtrimi i bazës nisëse është një proces i cili në aspektin metodologjik do të përpunohet dhe do të zbatohet më tutje nën koordinimin e Agjencisë së të Rinjve dhe Sportit, por në bashkëpunim me të gjitha institucionet kompetente në nivelin nacional dhe lokal të cilët do të paraqiten në rolin e realizuesve të aktiviteteve të strategjisë.

Vetë procesi i ndjekjes së realizimit dhe sukcesi i strategjisë do të koordinohet nga ana e Agjencisë së Rinisë dhe Sportit, por grumbullimin faktik i të dhënave dhe informimin do ta bëjnë të gjitha institucionet të cilat do të realizojnë aktivitete të strategjisë në kuadër të programeve të tyre. Në nivel tremujor

do të grumbullohen të dhënat e nevojshme nga ana e institucioneve, ndërsa informimi do të jetë gjysëmvetor ose vjetor dhe gjithësesi në funksion të proceseve të përcaktuara me planit të cilat zhvillohen në nivel nacional (për shembull para përgatitjes së cirkularit buxhetor për vitin e ardhshëm, institucionet duhet të dorëzojnë të dhëna për realizimin e aktiviteteve të strategjisë). Për të unifikuar dhe koordinuar tërësisht procesin Agjencia e Rinisë dhe Sportit në kuadër të Planit për ndjekjen dhe vlerësimin e suksesit nga implementimi i strategjisë do të përgatisë një varg instrumentesh/formatesh në të cilat institucionet do të prezantojnë të dhënat e grumbulluara, si dhe formate të veçanta për informim të bazuar në realizimin e masave dhe objektive të përcaktuara në nivel gjysëm vjetor ose vjetor.

Gjatë realizimit të strategjisë planifikohet një proces valorizimi në fund të tri viteve të para nga implementimi me qëllim të konfirmimit të ndryshimeve të nevojshme për periudhën e ardhshme. Gjithashtu pas implementimit në pesë vitet e para të realizimit është paraparë valorizimi i efekteve të implementimit të deriatëhershëm. Përgatitjet për zbatimin e impakt-valorizimit do të fillojnë menjëherë pas kalimit të periudhës pesëvjeçare të realizimit, ndërsa raporti me të dhëna impakti i implementimit të strategjisë duhet të jetë gati dhe i prezantuar para opinionit gjashtë muaj pas skadimit të periudhës dhjetëvjeçare të kësaj strategjie. Ai (impakti) do të shërbejë si bazë për hartimin e strategjisë së ardhshme.



*Vetë procesi i ndjekjes së realizimit dhe sukcesi i strategjisë do të koordinohet nga ana e Agjencisë së Rinisë dhe Sportit, por grumbullimin faktik i të dhënave dhe informimin do ta bëjnë të gjitha institucionet të cilat do të realizojnë aktivitetet e strategjisë në kuadër të programeve të tyre*



## LISTA E LITERATURËS SË SHFRYTËZUAR DHE DOKUMENTET RELEVANTE GJATË PËRPILIMIT TË STRATEGJISË

- Strategjia nacionale për të rinj 2005-2015
- Trendet rinore në R. Maqedonisë, Instituti i Hulumtimeve Sociologjike, Politike-juridike. Shkup 2014
- Papunësia- Rreziqe dhe sfida, Instituti i Hulumtimeve Sociologjike, Politike-juridike. Shkup 2013
- Të rinjtë dhe tregu i punës, Reaktor 2012
- Depërtimi i të rinjve dhe të rejave në tregun e punës në IRJM, Organizata Ndërkombëtare e Punës, Qershor 2013
- Analiza: Nevojat rinore dhe organizimi rinor, Koalicioni TANI (CEFA) Prilep, 2010
- Raporti për realizimin e Planit të veprimit për implementimin e SNR në RM, ARS, Shkup 2015
- Plani nacional i veprimit për punësim të të rinjve 2013-2015
- Plani nacional për punë të denjë 2010- 2013, MSHT, Shkup 2019
- Puna sipërmarrëse në Maqedoni, GEM, Shkup. 2012
- Programi nacional për zhvillimin e arsimit 2005-2015
- Strategjia nacionale për punësim 2011-2015
- Plani nacional i veprimit për punësim të të rinjve 2013-2015
- Ligji i mbrojtjes shëndetësore Nr. 07-1704/1 i 28 mars 2012 (Gazeta zyrtare e RM, nr. 43 e 29.3.2012)
- Kaptina 4 e Buletinit statistikor vjetor të Republikës së Maqedonisë i vitit 2013 (04. Shëndetësi, kushtet sociale dhe kultura)
- Organizata botërore e shëndetësisë (OBSh)
- Të drejtat e njeriut në mbrojtjen shëndetësore (<http://www.healthrights.mk/>)
- Doracak për edukator moshanik në tema nga shëndeti dhe e drejta seksuale dhe reproduktive (H.E.R.A)- Agjencia e Edukimit dhe Hulumtimit Shëndetësor, 2915)
- Objektivat dhe prioritetet strategjike të politikave demografike në Republikën e Maqedonisë/ Prioritetet e seleksionuara për vitin 2015/2016 për përgatitjen e planit të veprimit në pajtim me Strategjinë e politikave demografike 2015-2024.
- Studim për sjelljen lidhur me shëndetin tek fëmijët e moshës shkollore (NBSC): Raport, 2013
- Strategjia nacionale për pakësimin e varfërisë dhe eksklusivitetit social në Republikën e Maqedonisë 2010-20120.
- Ligji i standardit të studentëve TEKST I KONSOLIDUAR (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 15/2013; 30/2013; 120/2013 dhe 40/2014
- Studim për të rinjtë në Republikën e Maqedonisë, FES 2013
- Nevojat rinore dhe organizimi rinor në Republikën e Maqedonisë, Koalicioni TANI (CEFA ), 2010
- Organizimi rinor në Maqedoni, Këshilli Nacional Rinor i Maqedonisë, 2014
- Koalicioni i organizatave rinore TANII (CEFA ) “Doracak për krijimin e strategjive lokale rinore”, 2010
- Strategjia nacionale për zhvillimin e Kulturës për periudhën 2013-2017 (përfshirë edhe Planin e veprimit për implementimin e Strategjisë nacionale për zhvillimin e Kulturës për periudhën 2013-2017)
- Pasqyra e politikave rinore në Maqedoni, Këshilli Nacional Rinor i Maqedonisë, Shkup 2015
- Kapitali social i nxënësve të shkollave të mesme të Maqedonisë, Forumi shkollor rinor, Reaktor hulumtim në veprim, 2011
- Programi për zhvillimin e sportit 2013-2017
- Ligji i sportit në RM
- Strategjia e BE për të rinjtë - informim dhe përforcim
- [http://ec.europa.eu/youth/policy/youth\\_strategy/index\\_en.htm](http://ec.europa.eu/youth/policy/youth_strategy/index_en.htm)





